



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 574 Akti

Nr. 630 Vendimi
Tiranë, më 3.3.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektoshi	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 1.3.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Hysen Ajasllari**, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysen Ajasllari, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues, të datës 19.6.2020, u caktua me mirëkuptim si kryesuese komisionerja Brunilda Bekteshi, si dhe u deklarua mospasja e asnjë konflikti interesi nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, , “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të

¹ Akt kontroll nr. *** prot., datë 12.12.2019.

arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerësoi se, ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 8.2.2023, vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40, 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 10.2.2023, u njoftua nëpërmjet postës elektronike, me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni, duke i dhënë një afat të arsyeshëm deri në datën 24.2.2023 për të paraqitur shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, si dhe për të marrë kopjen e saj elektronike në datën 13.2.2023.

16. Në datën 24.2.2023, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të ftojë² atë në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë përmes postës elektronike, në datën 24.2.2023.

² Me vendimin nr. ***, datë 24.2.2023, të trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Hysen Ajasllari, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 1.3.2023, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

19. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë, me arsyetimin se ka arritur nivelin e besueshmërisë për të tria kriteret.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Hysen Ajasllari ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve dhe duke paraqitur brenda afatit të caktuar shpjegimet përfundimtare, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017³ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

³ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.6 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (e) denoncimet e publikut; (ë) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A.VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar "*Vetting*", duke e krahasuar me deklaratimet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në këtë institucion, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

22.2 Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive.

22.3 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar (referuar në vijim "*Vetting*"), të datës 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar pasuritë (e paluajtshme dhe të luajtshme), si vijon:

23. Shtëpi banimi me sipërfaqe të katit përdhes 99.6 m² dhe sipërfaqe të katit të parë 120.6 m², si dhe truell prej 200 m². Vlera: 6,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Vërtetuar sipas certifikatës së pronësisë me z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, me adresë lagjja "****", Fier.

23.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar blerjen e truallit në vitin 1998, me vlerë 380,000 lekë, sipas aktmarrëveshjes dhe më pas ndërtimi ndër vite nga kursimet familjare të punës së tij dhe të bashkëshortes.

23.2 Deklarimet e pasurisë objekt vlerësimi ndër vite

i. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, datë 6.6.2004 (në vijim "deklarata fillestare e pasurisë"), subjekti ka deklaruar: "*Shtëpi banimi në ndërtim e sipër, vlefte 2,000,000 lekë, pjesa takuese 50%, vendndodhja Ç, Fier (M), pasuria nr. regi. hipoteke ***, ***, datë 12.10.1998, me burim krijimi blerë nga shtetasja Z.M trualli, nga kursimet*".

ii. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim “DIPP”) të vitit 2005, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 400,000 lekë.

iii. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 250,000 lekë.

iv. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 300,000 lekë.

23.3 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën e investuar në banesën 2-katëshe në Fier, pasi referuar deklaratave të interesave privatë 2003 – 2007 janë deklaruar shpenzime për ndërtimin e saj në vlerën totale rreth 3,000,000 lekë, kurse në deklaratën e pasurisë Vetting është deklaruar vlera 6,000,000 lekë.
- Është e paqartë periudha e ndërtimit, vlera e investuar, burimi financiar i përdorur, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor preventiv/situacion për ndërtimin e banesës 2-katëshe në Fier.
- Subjekti nuk ka deklaruar pasurinë truall me sip. 35 m² në Fier, të konfirmuar nga ZVRPP-ja Fier.

24. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me këtë pasuri

24.1 Nga hetimi i Komisionit, ASHK Drejtoria Vendore Fier⁴ ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit figurojnë dy pasuri, me të dhënat si vijon:

i. Pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë truall me sip. 200 m², nga e cila 99.6 m² ndërtesë (me shënim godinë banimi dykatëshe, kati përdhes me sip. 99.6 m² dhe kati i parë me sip. 120.6 m²), e pajisur me certifikatë pronësie në datën 4.3.2013, pasuria objekt vlerësimi.

ii. Pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji i pasurisë truall me sipërfaqe totale 35 m², e papajisur me certifikatë pronësie, me shënimin “sipërfaqja e truallit është jashtë dokumentit ligjor”.

24.2 Nga administrimi i tërësisë së dokumentacionit⁵ të siguruar gjatë hetimit të Komisionit në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi (truall dhe ndërtesë) kanë rezultuar faktet që lidhen me mënyrën e përfitimit të truallit dhe ndërtimit të banesës, si vijon:

i. Me vendimin nr. ***, datë 9.7.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur⁶ njohja e faktit juridik të pronësisë mbi një tokë truall me sip. 400 m² dhe shtëpi banimi të ndodhur në lagjen “****”, Fier.

ii. Referuar fakteve të përmbajtura në vendim, vihet re e shënuar se, në lidhje me këtë pasuri subjekti i rivlerësimit paraprakisht është pajisur me lejen e sheshit të ndërtimit, miratuar me vendimin nr. ***, datë 26.9.1994, të Këshillit Bashkiak Fier, mbi bazën e së cilës ka ndërtuar banesën 1-katëshe me konstruksion themele betoni, muret me blloqe, shtruar me çimento,

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Fier (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.11.2020).

⁵ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës Vetting (ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); (ii) dokumentacioni i dërguar nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Fier (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.11.2020); dhe (iv) shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2017, e ZVRPP-së Fier, e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2017, të ZQRPP-së, në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi nr. ***, f. ***.

⁶ Vendim nr. ***, nr. **** regj. themel., datë 9.7.1998, i ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

mbuluar me soletë, e përbërë nga një dhomë, kuzhinë me anekse, koridore dhe banjë. Ky vendim gjykate është regjistruar në regjistrat e Hipotekës Fier, datë 12.10.1998, me nr. *** regjistri dhe nr. ***, sipas të cilit është shënuar: *“Lëshohet notë transkriptimi⁷ në favor të Hysen Ajasllari për pasurinë tokë truall me sipërfaqe 400 m² dhe shtëpinë e banimit të ndodhur në lagjen ‘***’ të qytetit të Fierit, banesa është 1 kat me konstruksion themele betoni, muret me blloqe, shtruar me çimento, mbuluar me soletë, përbëhet nga një dhomë, kuzhinë me anekse, koridore dhe banjë, të ndodhur në lagjen ‘***’, Fier”.*

iii. Nga verifikimi i deklaramit të parë të kryer nga subjekti në ILDKPKI, evidentohet se subjekti ka deklaruar shtëpi banimi në ndërtim e sipër me të njëjtin numër regjistrimi hipoteke, sikurse referuar në notën e transkriptimit të vendimit të gjykatës, por duke cituar si mënyrë përfitimi pronësie të truallit, blerje nga shtetasja Z.M.

iv. Me qëllim verifikimin e mënyrës së përfitimit të pronësisë mbi pasurinë objekt vlerësimi, Komisioni kërkoi⁸ dokumentacionin mbi bazën e të cilit është vërtetuar fakti juridik i pronësisë me vendim gjykate. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, nga ana tjetër, për sa është kërkuar nga Komisioni, paraqiti⁹ kopje të dosjes gjyqësore, nga administrimi i së cilës vërehet se në datën 26.6.1998, subjekti ka paraqitur padinë civile me palë të paditur Bashkinë Fier, me objekt “njohje pronësie mbi tokë truall me sip. 400 m² dhe shtëpi banimi”, duke u bazuar në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, “vërtetimi gjyqësor i fakteve”.

v. Nga analizimi i kërkesëpadisë vërehet se, subjekti në padinë drejtuar gjykatës ka deklaruar se në vitin 1992 ka blerë nga shteti një truall me sip. 400 m², mbi të cilin ka ndërtuar një shtëpi banimi 1-katëshe, me konstruksion themele betoni, muret me blloqe, shtruar me çimento, mbuluar me soletë, e përbërë nga një dhomë, kuzhinë me anekse, koridore dhe banjë. Shtëpinë e ka ndërtuar me leje të organeve kompetente me shesh dhe leje ndërtimi, duke theksuar se nuk e ka regjistruar në hipotekë dhe për këtë arsye i është drejtuar gjykatës me qëllim regjistrimin e saj.

vi. Më tej, nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur si provë nga subjekti para gjykatës vërehet një vendim për dhënie shesh ndërtimi i plotësuar me shkrim dore për z. Hysen Ajasllari për truallin nr. ***, miratuar me vendimin nr. ***, datë 26.9.1994, të Këshillit Bashkiak, në të cilin konstatohet se numri i vendimit është i ndryshëm nga numri i vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit që referon Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për njohjen e vërtetimit të faktit juridik. Gjithashtu konstatohet se bashkëlidhur vendimit për dhënie shesh ndërtimi gjendet një planimetri e sheshit të ndërtimit të objekteve shtëpi banimi sipas studimit në ***, e cila duket se nuk lidhet me vendimin për shesh ndërtimi, pasi konstatohet se është miratuar me vendim tjetër të KRT-së (pra me vendimin nr. ***, datë 6.7.1994) dhe se trualli nr. ***, për të cilën referohet sheshi i ndërtimit për subjektin në vendimin për dhënie sheshi, i është shënuar një shtetasi tjetër¹⁰ në planimetri. Në këtë planimetri gjithashtu evidentohet e shënuar: *“Sheshi ka afat 3 muaj deri në ditën e marrjes së lejes së ndërtimit. Qytetarët pasi të marrin firmat e sheshit të ndërtimit do të sjellin projektin e plotë të ndërtimit, pastaj do të pajisen me leje ndërtimi”.*

vii. Gjatë hetimit administrativ¹¹ subjekti konfirmoi se ka pasur një leje ndërtimi, mbi bazën e së cilës ka kërkuar njohjen gjyqësisht të pronës mbi tokën truall me sip. 400 m², ku mbi bazën e saj gjykata i ka dhënë të drejtën e njohjes mbi pronën tokë truall me sip. 400 m² dhe shtëpi banimi të ndodhur në lagjen “***”, Fier.

⁷ Notë transkriptimi e ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; kthim përgjigjeje me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2022; shkresë vijuese e Komisionit me nr. *** prot., datë 10.1.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2023, lëshuar nga Arkiva Shtetërore e Sistemit Gjyqësor.

⁹ Në përgjigje të pyetësorit ***, paraqitur me email-in e datës 13.1.2023.

¹⁰ Duket i shënuar emri V.T.

¹¹ Shihni përgjigjen *** të pyetësorit nr. ***.

viii. Komisioni, nisur nga faktet kontradiktore të konstatuara gjatë hetimit në lidhje me lejen e sheshit/ndërtimit, i kërkoi¹² organeve kompetente informacion në lidhje me lejen e lëshuar në emër të subjektit, si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të plotë mbi bazën e të cilit janë lëshuar lejet/miratimet teknike.

ix. Organet kompetente¹³ nuk konfirmuan që subjekti i rivlerësimit të jetë pajisur me leje ndërtimi për shtëpinë e banimit në lagjen “****”, Fier.

x. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë aktmarrëveshjen për blerjen e truallit nga shtetasja Z.M, referuar nga subjekti në deklarinimin e kohës, si dhe në atë *Vetting*, si mënyrë përfitimi pronësie për pasurinë objekt vlerësimi. Subjekti i rivlerësimit paraqiti¹⁴ aktmarrëveshjen datë 17.6.1998, lidhur midis shtetasës Z.M dhe z. Hysen Ajasllari.

xi. Sipas kësaj marrëveshjeje citohet se shtetasja Z.M ka në pronësi një sipërfaqe tokë truall prej 400 m² në lagjen “****”, Fier dhe mbi këtë truall ka ndërtuar një shtëpi banimi të përbërë nga një dhomë e koridor, e papërfunduar, të cilën deklaroi se ia shet në të ardhmen me dokumente të rregullta dhe akt noterial shtetasit H. M, nëpërmjet një kapari në shumën prej 380,000 lekësh, të dhënë nga z. Hysen Ajasllari.

xii. Në kuadër të hetimit, Komisioni ka verifikuar¹⁵ dhe analizuar historikun e regjistrimit të kësaj pasurie, nga ku ka konstatuar se pasuria në fillim ka qenë e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, me të dhëna truall me sip. 435 m² dhe ndërtesë me sip. 167 m², regjistrimi i së cilës është mbyllur dhe ka vijuar në tri pasuri:

- pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall” me sip. 400 m²;
- pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “ndërtesë”;
- pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall” me sip. 35 m².

xiii. Në vijim, pasuria truall dhe ndërtesë është regjistruar me nr. ***, vol. ***, f. ***, nga ku truall prej 400 m² dhe ndërtesë prej 167 m². Në lidhje me këtë regjistrim konstatohet se është regjistruar mbi bazën e një vetëdeklarimi¹⁶ datë 14.8.2006¹⁷ të subjektit dhe vëllait të tij A.A, me objekt “legalizimin e një objekti të llojit banesë dykatëshe, me funksion banimi, me sipërfaqe të zënë 400 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 167 m²”, të ndodhur në lagjen “****”, ***, Fier dhe kohë ndërtimi datë 10.11.1998.

xiv. Në datën 23.1.2009 ZVRPP-ja Fier ka lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit certifikatën për vërtetim pronësie¹⁸ të llojit “truall” me sip. 400 m², nga të cilat 107 m² ndërtesë, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***.

xv. Për efekt të procesit të legalizimit të ndërtesës, datë 3.12.2012, subjekti dhe vëllai i tij S (A) A kanë nënshkruar një deklaratë noteriale¹⁹, sipas së cilës subjekti deklaroi se shtëpia është ndërtuar mbi truallin në pronësi të tij, vërtetuar me certifikatën për vërtetim pronësie datë 23.1.2009, për të cilin nuk kërkon kompensim financiar nga vëllai dhe shpreh dakordësinë që objekti informal dykatësh i vetëdeklaruar nga subjekti dhe vëllai i tij pranë ALUIZNI-t Fier në

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 19.12.2022, drejtuar Bashkisë Fier; shkresë nr. *** prot., datë 10.1.2023, drejtuar Këshillit të Qarkut Fier.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2022, e Bashkisë Fier dhe shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2023, e Këshillit të Qarkut Fier.

¹⁴ Në përgjigje të pyetësorit ***, paraqitur me *email*-in e datës 13.1.2023.

¹⁵ Nga analizimi i përgjigjes së ardhur nga ZVRPP-ja Fier me shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁶ Vetëdeklarim nr. ***, datë 14.8.2006, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

¹⁷ Të kryer para njësisë së urbanistikës së qeverisjes vendore Fier.

¹⁸ Certifikatë për vërtetim pronësie e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

¹⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2012, e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

vitin 2006 të vijojë procedurat e legalizimit për të dy vetëdeklaruesit dhe, për rrjedhojë, leja e legalizimit të lëshohet në emër të të dy vëllezërve si bashkëpronarë.

xvi. Në vijim, në datën 22.1.2013 është lëshuar leja e legalizimit²⁰ në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij S.A, për pasurinë e llojit “godinë banimi 2-katëshe”, me të dhënat: *Sipërfaqe të parcelës ndërtimore 400 m², sipërfaqe ndërtimi 189.6 m² dhe sipërfaqe totale e ndërtimit për banim 407.8 m², të ndodhur në lagjen “****”, Fier. Titulli i pronësisë mbi tokën, certifikatë për vërtetim pronësie nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, lëshuar nga ZVRPP-ja Fier.*

xvii. Pasi janë kryer procedurat e regjistrimit të lejes së legalizimit në regjistrat hipotekorë, në datën 11.2.2013 është lëshuar certifikata²¹ për vërtetim pronësie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, me të dhënat: *Pasuri nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall” me sip. 400 m², nga ku ndërtesë me sip. 189.6 m², me shënim në kartelë “godinë banimi 2 kate, kati përdhes 189.6 m² dhe kati i parë 218.2 m²”.*

xviii. Me regjistrimin e lejes së legalizimit, pasuria truall dhe ndërtesë është ndarë midis vëllezërve mbi bazën e një kontratë noteriale²² pjesëtimi vullnetar të datës 13.2.2013, e nënshkruar midis vëllezërve dhe bashkëshorteve përkatëse, e shoqëruar me planrilevimin datë 12.2.2013, ku është përcaktuar se subjekti i rivlerësimit do të marrë në pronësi të tij një sipërfaqe prej 200 m² (1/2 e truallit), 99.6 m² në katin përdhes dhe 120.6 m² në katin e parë, ndërsa vëllai i subjektit do të marrë në pronësi të tij sipërfaqen e mbetur prej 200 m² (1/2 tjetër të truallit), 90 m² në katin përdhes dhe 97.6 m² në katin e parë.

xix. Kontrata e pjesëtimit është regjistruar në regjistrat hipotekorë në datën 4.3.2013, ku në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “truall” me sip. 200 m², nga e cila 99.6 m² ndërtesë (me shënim “godinë banimi dykatëshe, kati përdhes me sipërfaqe 99.6 m² dhe sipërfaqe kati i parë 120.6 m²”), e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

xx. Gjatë hetimit administrativ Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me arsyen e përfshirjes së shtëpisë në procesin e legalizimit, në rrethanat kur subjekti kishte deklaruar se shtëpinë e kishte ndërtuar me leje ndërtimi. Subjekti i ka qëndruar faktit të ndërtimit të shtëpisë mbi bazën e lejes së ndërtimit, duke shtuar se²³ në proces legalizimi ka kaluar vetëm shkallët, të cilat i ka shtuar përtej sipërfaqes së ndërtesës me leje ndërtimi.

xxi. Për të vërtetuar deklarin e subjektit, Komisioni analizoi dokumentacionin e tërhequr nga ALUIZNI, nga analizimi i të cilit u konstatua se në proces legalizimi ishte përfshirë e gjithë ndërtesa dhe jo shkallët, sikundër pretenduar nga subjekti.

25. Në lidhje me kohën e fillimit të banimit të subjektit në shtëpinë objekt vlerësimi

25.1 Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë së subjektit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti e ka deklaruar si adresë banimi adresën ku ndodhet pasuria objekt vlerësimi që nga deklarata e parë e pasurisë e në vijim deri në DIPP-në e vitit 2016.

25.2 I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar²⁴ se *është transferuar në qytetin e Fierit në vitin 2003 në adresën lagja “****”, “****” dhe në datën 1.3.2004 është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, ku edhe banon aktualisht.*

25.3 Nga hetimi i Komisionit, DPGJC-ja konfirmon²⁵ se subjekti ka ndryshuar vendbanim nga Njësia Administrative Çorovodë në Bashkinë Fier në datën 2.7.2002.

²⁰ Leje legalizimi me nr. ***, e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

²¹ Certifikatë pronësie me nr. serial ***, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

²² Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.2.2013, redaktuar nga noteri publik F Xh. Z, e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, f. ***.

²³ Shihni përgjigjen e pyetjes *** të pyetësorit ***.

²⁴ Pyetësori nr. ***, i dërguar nga Komisioni.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.12.2022.

26. Në lidhje me pasurinë truall me sipërfaqe totale 35 m², në lagjen “*”, Fier, pjesë e pasurisë objekt vlerësimi**

26.1 Gjatë hetimit të Komisionit në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, është evidentuar e regjistruar²⁶ në regjistrat e pasurive të paluajtshme pasuria truall me sip. 35 m², por e papajisur me certifikatë pronësie. Nga analizimi i historikut të regjistrimit të kësaj pasurie duket se në fillim ka qenë e regjistruar bashkë me sipërfaqen e truallit, në total prej 435 m², dhe në vijim është ndarë.

26.2 I pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri, për shkak të mosdeklarimit prej tij në asnjë deklaratë pasurie, subjekti ka sqaruar²⁷ se për këtë pasuri nuk ka pasur ndonjëherë pretendime dhe prandaj nuk e ka deklaruar. Ai ka sqaruar se pasuria është jashtë truallit të tij, për të cilën nuk ka qenë në dijeni se ka qenë e regjistruar në emrin e tij dhe me këtë fakt është njohur në momentin që janë bërë matjet faktike për shtëpinë. Subjekti ka pretenduar se për këtë fakt ka bërë deklaratë në zyrën e ALUIZNI-t dhe është vënë në dijeni se kjo pasuri si diferencë do të përdoret nga ana e bashkisë për zgjerimin e rrugës, duke e mbështetur deklarin e tij në një genplan dhe hartë treguese të pasurisë shtëpi banimi, sipas së cilës ka pretenduar se pasuria është e kufizuar pikërisht me pasurinë truall me sip. 35 m², regjistruar me nr. ***.

26.3 Për të vërtetuar deklarin e subjektit, Komisioni iu referua praktikës së ALUIZNI-t, të tërhequr për shkak të hetimit, por nuk eidentoi të depozituar ndonjë deklaratë të pretenduar nga subjekti në lidhje me pasurinë truall prej 35 m². Gjithashtu, nga administrimi i akteve të paraqitura nga subjekti në mbështetje të shpjegimeve të tij, nuk provohet e kundërta e faktit të ekzistencës së regjistrimit të pasurisë truall prej 35 m² në emër të subjektit të rivlerësimit.

26.4 Bazuar në faktet e konstatuara nga hetimi në lidhje me pasurinë truall/shtëpi banimi, si dhe truall prej 35 m², Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, për sa duket se: (i) nuk përputhet deklarin i subjektit në deklaratën *Vetting* me dokumentacionin e administruar nga hetimi i Komisionit në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë truall, pasi pasuria në deklaratën *Vetting* është deklaruar e përfituar me aktmarrëveshjen e vitit 1998, ndërkohë nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti i është drejtuar gjykatës për të kërkuar vërtetim fakti juridik mbi pronësinë e truallit dhe shtëpinë e banimit, duke e bazuar titullin e pronësisë së truallit mbi një akt shitblerjeje nga shteti që në vitin 1992; (ii) nuk provohet përfitimi i pasurisë së deklaruar nga subjekti me burim nga aktmarrëveshja e vitit 1998, pasi nga analizimi i përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje konstatohet se ajo është lidhur për të rregulluar angazhimin e palëve për blerjen e truallit dhe shtëpisë së banimit në të ardhmen dhe se për kalimin e titullit të pronësisë mbi të, subjekti i rivlerësimit dhe shitësja (znj. M), nga ana tjetër duhej që të lidhnin një akt noterial shitblerjeje dhe në vijim ta regjistronin këtë titull bazuar në nenet 83 dhe 750 të Kodit Civil. Ndërkohë, nga hetimi rezultoi se në kadastër figuronte e regjistruar pasuria truall dhe ndërtesë mbi bazën e vendimit për vërtetimin e faktit juridik, në kushtet kur neni 193 i Kodit Civil e ndalonte regjistrimin e vërtetimit gjyqësor të faktit të pronësisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme; (iii) nga hetimi i Komisionit rezultoi se Bashkia Fier/Këshilli i Qarkut Fier nuk konfirmuan ta kenë pajisur subjektin e rivlerësimit me leje sheshi/ndërtimi për ndërtimin e shtëpisë në lagjen “***”, Fier, sikurse deklaruar nga subjekti dhe se nga ana tjetër nga administrimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti për leje sheshi dhe planimetri u evidentuan të dhëna që nuk përputheshin me njëra-tjetrën, sikurse trualli i përcaktuar me vendim sheshi për subjektin e rivlerësimit dhe referenca mbi përkatësinë e tij sipas planimetrisë së sheshit bashkëlidhur, planimetri e cila dukej se ishte miratuar me një vendim tjetër të KKRT-së; (iv) nga analizimi i dokumentacionit të ALUIZNI-t nuk dukej se procesi i legalizimit të ndërtesës është kryer për shkak të ndryshimit/shtimit të shkallëve të saj, sikurse deklaruar nga subjekti;

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.11.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Fier (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.11.2020).

²⁷ Shihni pyetësorin ***.

(v) për sa më lart, krijohen dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e deklaramit të subjektit për pasurinë objekt vlerësimi, si dhe të veprimeve të ndërmarra prej tij për përfitimin e kësaj pasurie, të cilat duket se cenojnë integritetin dhe etikën e tij si magjistrat; (vi) subjekti nuk ka deklaruar pasurinë truall prej 35 m², të figuruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme Fier, në emër të subjektit të rivlerësimit. Subjekti duhet të provojë me dokumentacion provues ligjor të kundërtën e konstatimit të Komisionit në lidhje me pasurinë truall prej 35 m²; (vii) subjekti duhet të provojë në lidhje me banimin e tij në Fier që nga viti 2002, referuar informacionit të marrë nga DPGJC-ja.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

27. Në lidhje me konstatimin e Komisionit mbi blerjen e truallit nga shteti, subjekti ka shpjeguar se nuk ka qenë ai që e ka blerë truallin nga shteti por shitësja Z.M, e cila e ka blerë në vitin 1992, por referimi i këtij fakti nga ana e tij në kërkesëpadinë drejtuar gjykatës ka qenë lapsus. Subjekti ka sqaruar se ka bërë kërkesë në gjykatë për njohje pronësie mbi truallin, të përfituar pikërisht sipas aktmarrëveshjes që ka lidhur në vitin 1998.

27.1 Në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë, subjekti ka theksuar se ka pasur një marrëveshje me shtetasen Z.M, me të cilën nuk ka arritur ta finalizojë kontratën e shitblerjes pasi se ka humbur kontaktet me të dhe, për këtë arsye, ka bërë regjistrimin mbi vendimin për vërtetim faktit juridik nga ana e kadastrës.

27.2 Për sa i përket lejeve teknike për ndërtimin e shtëpisë, subjekti ka shpjeguar se është interesuar në Bashki dhe në Këshillin e Qarkut, por ato i kanë bërë me dije se nuk gjenden këto dokumente. Më tej, ai ka shpjeguar se ka ndjekur procesin e legalizimit, pasi nuk është marrë në konsideratë vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj. Në lidhje me këtë fakt ai ka theksuar para Komisionit se për shkak të shtimit të shkallëve, si dhe kalimit të një afati të gjatë nga momenti i dhënies së lejes nga bashkia, ka ndjekur rrugën e legalizimit.

27.3 Subjekti ka theksuar se në asnjë rast nuk ka kryer veprime fiktive për përfitimin e kësaj pasurie apo fshehje të saj, por i ka quajtur ato veprime parregullsi, të kryera për vetë faktin se ligji nuk ka qenë i rregulluar në rastet e ndërtimit të një banese.

27.4 Në lidhje me pasurinë truall prej 35 m², të padeklaruar, subjekti ka theksuar se nuk e ka deklaruar pasi nuk e ka ditur që kjo sipërfaqe trualli ka qenë e regjistruar në emrin e tij. Për të provuar këtë deklaramit subjekti paraqiti në cilësinë e provës shkresën e datës 21.2.2023, lëshuar nga ASHK-ja Fier, sipas së cilës citohen të dhëna në lidhje me gjendjen e regjistrin të pasurive të paluajtshme për pasuritë e regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe pasurinë truall prej 35 m². Në lidhje me këtë pasuri, i pyetur në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se e ka rrethuar me mur, por nuk disponon titull pronësie. Më tej, i pyetur për masat e ndërmarra për ta çregjistruar nga pronësia e tij këtë pjesë të truallit, subjekti deklaroi para trupit gjykues se këtë çështje e ka menaxhuar nëpërmjet një takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, ku ka rënë në dijeni të faktit se shoqëria që ka kryer fotografimin ajror të zonës e ka fotografuar gabimisht atë pjesë si pjesë të truallit të tij.

27.5 Për sa i përket konstatimit të Komisionit në lidhje me transferimin e gjendjes civile nga qyteti i Çorovodës në Fier dhe faktit të banimit që nga viti 2002, subjekti i rivlerësimit nuk dha komente/shpjegime, por paraqiti një kopje të kërkesës datë 15.2.2023, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile Tiranë në lidhje me këtë fakt, për të cilën pretendoi se ishte ende në pritje të informacionit, që nuk e paraqiti deri në përfundim të seancës dëgjimore, pas së cilit ky konstatim mbeti i paprovuar.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

28. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e subjektit të paraqitura para Komisionit në raport me faktet e konstatuara nga hetimi, e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, si dhe pasi u

konsultua me legjislacionin në fuqi për secilën çështje të rezultuar në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, arsyetoni se:

28.1 Në lidhje me pronësinë e pasurisë objekt vlerësimi, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor në formën e parashikuar nga ligji përfitimin e saj në një nga mënyrat e përcaktuara në nenin 163²⁸ e vijues të Kodit Civil. Subjekti pretendoi se këtë pasuri e ka përfituar nëpërmjet aktmarrëveshjes së vitit 1998 nga shtetasja Z.M, por nuk provoi para Komisionit lidhjen e kontratës së shitblerjes dhe regjistrimin e saj, me qëllim që veprimi juridik të njihej sipas legjislacionit në fuqi, nenet 83 dhe 750 të Kodit Civil.

28.2 Nga ana tjetër, me veprime aktive e duke shfrytëzuar dispozitat ligjore në lidhje me vërtetimin gjyqësor të fakteve, rregulluar nga neni 388 i Kodit të Procedurës Civile, arrin të vërtetojë faktin e pronësisë mbi pasurinë pa qenë në asnjë nga rastet²⁹ e parashikuara nga kjo dispozitë ligjore dhe, për më tepër, arrin ta regjistrojë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me nenin 193 të Kodit Civil.

28.3 Për sa i përket faktit të ndërtimit të shtëpisë, subjekti dështoi të provonte në lidhje me disponimin e lejeve teknike (sheshi dhe ndërtimi) të nevojshme, sikurse deklaruar. Për më tepër, gjatë hetimit të kryer nga Komisioni u ngritën dyshime të arsyeshme në lidhje me fiktivitetin e lejes së përdorur nga subjekti në procesin gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronësisë së truallit dhe shtëpisë së banimit, nisur nga të dhënat kontradiktore të konstatuara në dokumentet leje sheshi dhe planimetria bashkëlidhur, për të cilat subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën.

28.4 Fakti i mosdisponimit të lejes së ndërtimit nga subjekti konsolidohet më tej me përfshirjen e shtëpisë në procesin e legalizimit, për të cilin subjekti u përpoq ta justifikonte me deklarime të ndryshme që lidheshin me shtimin e shkallëve apo me kalimin e afatit të gjatë nga momenti i dhënies së lejes nga bashkia, deklarime këto të cilat nuk arritën të provoheshin asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit.

28.5 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të tregonte konsistencë në deklaratimet e tij, duke kryer deklarime të ndryshme në deklaratat e pasurive gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në prapësimet përfundimtare me dërgimin e rezultateve të hetimit, në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke e bërë të pabesueshëm deklarin e tij dhe deri në nivelin e një deklarimi të rremë.

28.6 Veprimet e subjektit me qëllim përfitimin e pasurisë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe sjellja e tij gjatë procesit të rivlerësimit me deklarime të pabazuara, me qëllim justifikimin e veprimeve të ndërmarra nga ana e tij, nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, i cili duhet të jetë përfaqësues i modelit të drejtësisë. Magjistrati, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë saj, është i detyruar t'i nënshtrohet një sërë rregullash të proklamuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare, si dhe në ligje dhe akte nënligjore që dalin në zbatim të tyre, rregulla të cilat kanë qëllim garantimin tek publiku të një figure të moralshme dhe me integritet të lartë. Trupi gjykues i çmon këto sjellje përtej standardeve etike, si dhe veprime që cenojnë besimin e publikut te magjistrati.

28.7 Në lidhje me pasurinë truall prej 35 m², trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit mbi mospasjen e pretendimeve për këtë pasuri, shkresën³⁰ e datës 21.2.2023, lëshuar nga ASHK-ja Fier në lidhje me këtë pasuri dhe nga analizimi i dokumentacionit të siguruar nga

²⁸ Mënyra e fitimit të pronësisë, neni 163: *“Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”*.

²⁹ Sipas kësaj dispozite, kërkuesi duhet t'i provojë gjykatës se akti që ka vërtetuar faktin e pronësisë ka humbur, është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër.

³⁰ *“Pasuria me nr. ***, z. k. ***, Fier, e regjistruar në vol. ***, f. ***, e llojit të pasurisë ‘truall’, me sipërfaqe totale 35 m², nga të cilat 35 m² truall, në pronësi të Hysen P. Ajasllari, i papajisur me certifikatë pronësie. Në këtë pasuri, në seksionin *** të kartelës së pasurisë ndodhet kufizimi ‘sipërfaqja e truallit është jashtë dokumentacionit tekniko-ligjor’. Në bazë të dokumentacionit të depozituar në praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie nuk rezultojnë të ketë titull pronësie për të vijuar me regjistrimin e kësaj pasurie”*

hetimi administrativ në lidhje me këtë pasuri, çmon se kjo pasuri në fillim ka figuruar pjesë e pasurisë truall dhe ndërtesë dhe në vijim është ndarë truall prej 400 m² dhe pjesa tjetër prej 35 m² truall. Pavarësisht se subjekti pretendoi se pasuria nuk është e tij, fakti që është regjistruar në emër të tij, pohimi nga vetë subjekti se pasuria është pjesë e pandarë e truallit ku është ndërtuar shtëpia e banimit, e rrethuar me mur rrethues dhe nga ana tjetër mosmarrja e ndonjë veprimi apo mospërdorimi i ndonjë mekanizmi ligjor nga ana e subjektit me qëllim heqjen/fshirjen e kësaj pasurie nga regjistri në pronësi të tij, për trupin gjykues vlerësohen si rrethana të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti e ka poseduar dhe gëzuar këtë pasuri ndër vite pa titull dhe, për rrjedhojë, ka pasur detyrimin e deklarimit në deklaratën e pasurisë përkatëse dhe atë *Vetting*.

28.8 Trupi gjykues vlerëson se me veprime dhe mosveprime përkundrejt kësaj pasurie, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë truall prej 35 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28.9 Trupi gjykues çmon se, bazuar në sa më lart, subjekti ndodhet në rrethanat e aplikimit të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, gjerat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklarim të rremë në lidhje me përfitimin e pasurisë truall dhe ndërtesë, si dhe ka fshehur pasurinë truall prej 35 m², ndodhur në lagjen “****”, Fier. Gjithashtu, nga vlerësimi tërësor, duke konsideruar veprimet e vazhdueshme të kryera nga subjekti për përfitimin e pasurisë dhe ndërtesë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimin ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me shtëpinë e banimit – analizimi i etapave të ndërtimit dhe vlera e investimit të kryer

29. Gjatë administrimit të deklarimeve vjetore, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklarimet vijuese në lidhje me shpenzimet për ndërtimin e shtëpisë, përkatësisht për këto vite:

a) Në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi në ndërtim e sipër, vlefte 2,000,000 lekë, pjesa takuese 50%, vendndodhja ***, Fier (M), pasuria nr. regj. hipoteke ***, ***, datë 12.10.1998, me burim krijimi blerë nga shtetasja Z.M trualli, nga kursimet*”.

b) Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (*shtëpi banimi*), janë kryer punime shtesë në vlerën 400,000 lekë.

c) Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (*shtëpi banimi*), janë kryer punime shtesë në vlerën 250,000 lekë.

ç) Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (*shtëpi banimi*), janë kryer punime shtesë në vlerën 300,000 lekë.

d) Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar shtëpi banimi me vlerë 6,000,000 lekë.

29.1 Në lidhje me periudhën e ndërtimit dhe kostot e shpenzuara për kryerjen e tij, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja, si dhe gjithashtu disa herë nga Komisioni gjatë procesit administrativ, për shkak të mospërputhjes së vlerës së shpenzimeve për secilin vit të deklaruar nga subjekti me vlerën totale të ndërtimit, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

29.2 Subjekti i rivlerësimin ka deklaruar³¹ në ILDKPKI se, shtëpinë ka filluar ta ndërtojë në vitin 2001 së bashku me vëllain e tij S.A dhe në fund të vitit 2003 ka qenë i ndërtuar vetëm kati i parë, për ndërtimin e të cilit nuk ka mbajtur ndonjë preventiv, por Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier ka përcaktuar vlerën e investimit të ndarë në dysh mes tij dhe vëllait. Ndërsa,

³¹ Referohuni procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive, të datës 29.1.2016, përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 15.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.12.2022.

përtej këtij deklarami, në dosjen e legalizimit, konkretisht në formularin e vetëdeklarimit, është konstatuar e deklaruar nga subjekti dhe vëllai i tij se viti i ndërtimit është 1998 (10.11.1998).

29.3 Ndërsa gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni, subjekti ka deklaruar³² se deri në vitin 2003 ka investuar në total, me gjithë blerjen e truallit, si dhe ndërtimin e shtëpisë, e cila ka qenë në ndërtim e sipër, rreth 2,000,000 lekë, ndërsa për vitet 2004 – 2013 ka investuar vlerën totale 3,030,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar se investimet për shtëpinë kanë vazhduar edhe pas vitit 2013, pasi në momentin e vlerësimit nga ALUIZNI shtëpia ka qenë pa u përfunduar.

29.4 Subjekti, më tej ka detajuar³³ shpenzimet për ndërtimin e shtëpisë për secilin vit, si vijon: *“...deri në vitin 2003 kam investuar në total me gjithë blerjen e truallit, si edhe ndërtimi, diku rreth 2,000,000 lekë, e cila ka qenë në ndërtim e sipër, gjithashtu në vitin 2005 kam investuar shumën prej rreth 400,000 lekësh, gjatë vitit 2006 shumën prej rreth 250,000 lekësh, në vitin 2007 kam investuar rreth 300,000 lekë, investime të cilat kanë vazhduar edhe më pas, në vitin 2008 në shumën rreth 300,000 lekë, si në ndërtim edhe në mobilim, në vitin 2009 janë përdorur rreth 250,000 lekë, për vazhdimin e mobilimit të shtëpisë, fonde të cilat kanë qenë nga shitja e apartamentit në vitin 2007, si dhe rreth 250,000 lekë kursime për vazhdimin e ndërtimit të shtëpisë, gjithashtu është vazhduar në ndërtimin në çdo vit, me sa më kujtohet, në vitin 2009 kam investuar rreth 280,000 lekë, në vitin 2010 kam investuar vlerën rreth 350,000 lekë, gjatë vitit 2011 kam vazhduar me investimin në vlerën rreth 300,000 lekë, gjatë vitit 2012 shumën prej rreth 400,000 lekësh, gjatë vitit 2013 shumën prej rreth 400,000 lekësh, si dhe në vitin 2014 vlera të ndryshme, pasi siç mund të kurseja nga puna vazhdoja të investoja në shtëpi”.*

29.5 Nga analizimi i këtyre deklaramive, duket se vlera totale e shpenzimeve e deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ për periudhën kohore 2001 – 2013 është rreth 5,230,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar vlerën prej 6,000,000 lekësh. Në funksion të deklaramive, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues ligjor.

29.6 Për shkak të procesit të rivlerësimit subjekti ka pasur detyrimin të paraqesë dokumentacionin e plotë ligjor, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj., bazuar në pikën 26 të udhëzimit³⁴ nr. 4095/2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive në zbatim të ligjit 84/2016...”.

29.7 Gjithashtu, edhe në kuptim të ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, subjekti ka pasur detyrimin të përgatisë dhe të paraqesë një preventiv shpenzimesh³⁵ për efekt të procesit të legalizimit.

29.8 Në këtë kuadër, duke mos pasur asnjë dokument provues në lidhje me shpenzimet e ndërtimit të kryera nga subjekti, që do të mund të provonte edhe kohën e kryerjes së shpenzimeve përkatësisht ndër vite, Komisioni, për të vlerësuar qasjen e subjektit në deklaramet e tij për shpenzimet e kryera, iu referua kostove mesatare të ndërtimit të EKB-së, ku për vitet e para të ndërtimit kostot³⁶ e ndërtimit për metër katror kanë qenë si vijon: (i) për vitin 2001 ka qenë 22,737 lekë; (ii) për vitin 2002 ka qenë 23,214 lekë; (iii) për vitin 2003 ka qenë 21,103 lekë, pra me një mesatare rreth 22,351 lekë/m². Për rrjedhojë, referuar kësaj mesatareje, vlera e ndërtimit të objektit deri në fund të vitit 2003 mund të ketë qenë rreth 2,400,000 lekë³⁷, pra e

³² Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

³³ Pyetësori nr. ***; i dërguar nga Komisioni.

³⁴ Lëshuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

³⁵ Për efekt të llogaritjes së taksës së ndërtimit në infrastrukturë, në të kundërt, vlera e investimit për efekt të përcaktimit të taksës së ndikimit në infrastrukturën e ndërtimeve të reja në proces legalizimi përcaktohet sipas rregullave të miratuara me Vendimin Nr. 1180, datë 5.8.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit të ardhurave të procesit të legalizimit”.

³⁶ Referuar udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001, udhëzimit nr. 3, datë 16.10.2002, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2003 për vitin 2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave në tregun e lirë të banësive dhe të koeficientit ‘K’ për qytetin e Fierit”.

³⁷ Sipërfaqe totale ndërtimi 107 m² * 22,351 lekë/m² = 2,391,557 lekë.

përafërt me vlerën e deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 në shumën 2,000,000 lekë, e në këtë kuptim vlera e deklaruar nga subjekti prej 2,000,000 lekësh është përfshirë në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni si vlerë shpenzimi ndërtimi deri në vitin 2003.

29.9 Pas vitit 2003 subjekti ka vijuar punimet e ndërtimit referuar të dhënave të rezultuara nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit të Komisionit. Konkretisht, referuar dokumentacionit të administruar nga dosja e legalizimit, konstatohet se subjekti së bashku me vëllain e tij kanë shtuar sipërfaqen e ndërtimit edhe katet e pasurisë objekt vlerësimi.

29.10 Referuar dokumentit “procesverbal konstatimi”³⁸, akt i cili duket se është mbajtur pas verifikimit të kryer në terren nga specialistët e Drejtorisë së ALUIZNI-t Fier mbi objektin, është konstatuar se: (i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 419.7 m²; (ii) sipërfaqja e bazës të objektit dykatësh është 189.6 m²; (iii) sipërfaqe për banim 407.8 m²: (a) kati përdhes 189.6 m²; dhe (b) kati i parë 218.2 m². Pra, duket se sipas verifikimit në terren e gjithë godina në datën 19.11.2012 ka pasur një sipërfaqe totale ndërtimi prej 407.8 m², e cila deri në atë moment posedohej në bashkëpronësi nga subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij.

29.11 Në datën 22.1.2013 është lëshuar leja e legalizimit³⁹ në emër të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij S.A, për objektin “ndërtim 2-katësh banimi, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 400 m², sipërfaqe ndërtimi 189.6 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi për banim 407.8 m²”, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë lagjja “****”, Bashkia Fier.

29.12 Për të vlerësuar qasjen e subjektit për deklarimin e vlerës totale të ndërtimit të shtëpisë së banimit, deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 6,000,000 lekë, në rrethanat kur subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet e ndërtimit për ndërtimin e ngritur sipas fakteve të konstatuara nga dosja e legalizimit, si dhe duke mos disponuar asnjë dokument provues (preventiv/situacion) për punimet e kryera nga subjekti, Komisioni analizoi vlerën e investimit, në të cilën është bazuar ALUIZNI për efekt të procesit të legalizimit. Referuar formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë⁴⁰ vlera e investimit për të gjithë pasurinë e legalizuar në tërësi (subjekti dhe vëllai i tij) është 12,089,031 lekë⁴¹, e cila proporcionalisht me pjesën takuese të subjektit duket të jetë rreth 6,500,000 lekë⁴², pra afërsisht sa vlera totale e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

29.13 Bazuar në analizën e fakteve më lart për efekt të kohëzgjatjes së punimeve dhe shpenzimeve të kryera, duket se punimet janë kryer deri në vitin 2012, pasi në janar të vitit 2013 është lëshuar leja e legalizimit për objektin. Nën logjikën e analizës së fakteve më lart në raport me deklarimin përfundimtar të subjektit në deklaratën *Vetting* në lidhje me vlerën totale të ndërtimit prej 6,000,000 lekësh, në analizën financiare paraprake për këtë pasuri Komisioni ka vlerësuar se: (i) deri në vitin 2003 shpenzimet e kryera për investimin janë reflektuar aq sa janë deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë dhe gjatë hetimit administrativ në vlerën 2,000,000 lekë; (ii) në vitet 2004 – 2012 janë kryer shpenzimet e tjera për shtesat, investimet, punimet e kryera në objektin kryesor dhe për ndërtimin në tërësi në shumën 4,000,000 lekë, e cila është shpërndarë mesatarisht për çdo vit për këtë periudhë kohore, pasqyruar në tabelën e analizës financiare⁴³ për periudhat 1994 – 2003 dhe 2003 – 2012.

Burimet e krijimit për blerjen e truallit dhe të ndërtimit të objektit

³⁸ Datë 19.11.2012.

³⁹ Leje legalizimi nr. ***, datë 22.1.2013, ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi nr. ***, f. ***.

⁴⁰ Vetëdeklarimi nr. ***, datë 14.8.2006, i ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi nr. ***, f. ***.

⁴¹ E llogaritur si vlerë mesatare e EKB-së në kohën e llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1180, datë 5.8.2008, “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizimin dhe mbledhjen e administrimit e të ardhurave të procesit të legalizimit...”.

⁴² Vlera 12,089,031 lekë / 407 m² * 220.2 m² = 6,540,551 lekë.

⁴³ Për ekonomi administrimi pasqyrohet në fund të trajtimit të burimeve që kanë shërbyer për ndërtimin e kryer.

30. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash kursimet familjare të punës së tij dhe të bashkëshortes.

30.1 Ndërsa në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti ka deklaruar si burim kursimet.

a. Burimet e deklaruara për kryerjen e investimit deri në vitin 2003

31. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar⁴⁴ në lidhje me burimet e krijimit për blerjen e truallit dhe fillimin e punimeve për shtëpinë, ku për blerjen e truallit në vlerën 380,000 lekë ka deklaruar se ka investuar bashkë me vëllain e tij z. S (A) A, për të cilën ka paguar gjysmën e çmimit, pra shumën 190,000 lekë, me kursimet nga puna e tij dhe bashkëshortes dhe pjesa tjetër është investuar nga vëllai. Ndërsa në lidhje me ndërtimin e banesës deri në vitin 2001, burimet fillestare kanë qenë nga shitja e apartamentit të banimit në datën 8.9.1998, në shumën 410,000 lekë, më pas kanë shërbyer të gjitha kursimet e mbledhura ndër vite.

31.1 Më tej, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë pjesën takuese të paguar nga vëllai i tij, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me të ardhurat e të vëllait, që kanë shërbyer si burim krijimi për pagesën e shumës 190,000 lekë për bashkinvestimin në blerjen e truallit.

31.2 Subjekti, në vijim, ka ndërruar deklarimin, duke u shprehur⁴⁵ se pagesën e vlerës 380,000 lekë e ka kryer me kursimet e tij dhe të bashkëshortes, për arsye se vëllai ka jetuar në atë kohë në Greqi dhe se verbalisht kanë rënë dakord që 50% e truallit do ta blinte i vëllai. Ai ka shtuar se pasi është kthyer i vëllai në Shqipëri ia ka shlyer vlerën prej 190,000 lekësh, për të cilën nuk disponon dokumentacion justifikues.

31.3 Për shkak se deklaratat e pasurive të kohës përfaqësojnë burim prove, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni verifikoi deklaratën e pasurisë të plotësuar nga subjekti para fillimit të detyrës, në të cilën ka kryer deklarimin për këtë pasuri, por nuk evidentoi që subjekti të ketë deklaruar faktin e blerjes së truallit bashkë me vëllain e tij.

31.4 Subjekti është pyetur në lidhje me mosdeklarimin, i cili ka shpjeguar se: *“Është një harresë nga ana ime, pasi secili ka ndërtuar në mënyrë të pavarur, si dhe me të ardhurat e veta dhe, për këtë arsye, gjatë gjithë kohës jam shprehur vetëm për pjesën time, megjithëse në legalizim është bërë një aplikim i vetëm për të dyja pronat (sqaroj se bashkia nuk ka pranuar aplikim më vete për secilin)”*.

31.5 Referuar aktmarrëveshjes së datës 17.6.1998, e cila shërben si i vetmi akt që dokumenton pagesën e çmimit të truallit në shumën 380,000 lekë, nuk evidentohet të jetë palë në marrëveshje vëllai i subjektit.

31.6 Për më tepër, nga hetimi administrativ i Komisionit është administruar nga dosja e legalizimit një deklaratë noteriale⁴⁶ e datës 3.12.2012, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Me anën e kësaj deklarate noteriale unë, deklaruesi Hysen Ajasllari, shpreh vullnetin tim se jam dakord që ky objekt i ndërtuar në truallin pronësi e imja të legalizohet edhe në emër të vëllait tim S (A) A, pa kërkuar asnjë kompensim financiar apo në natyrë për truallin pronësi e imja dhe mbi të cilën është ngritur kjo godinë...”*.

31.7 Në vlerësim të këtyre fakteve, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vlerën e plotë të çmimit të blerjes së truallit prej 380,000 lekësh, për sa rezultuan këto fakte: (i) nga dokumentacioni i siguruar nga hetimi rezultoi si pronar vetëm subjekti i rivlerësimit; (ii) mosdeklarimi në asnjë deklaratë pasurie të bashkinvestimit për blerjen e tokës me të vëllain.

⁴⁴ Në pyetësozin e parë.

⁴⁵ Shihni përgjigjen e pyetjes *** të pyetësozit ***.

⁴⁶ Me nr. *** rep. nr. *** kol.

31.8 Komisioni më tej hetoi në lidhje me burimet e deklaruara nga subjekti për pagesën e çmimit të truallit, si dhe të ndërtimit të kryer deri në këtë periudhë. Në lidhje me burimin e parë – të ardhurat nga shitja e banesës apartament 1+1 në Skrapar – nga hetimi i Komisionit, konfirmohet nga ASHK Skrapar⁴⁷ se në datën 2.7.1993, me anë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, subjekti ka përfituar⁴⁸ një apartament 1+1, me sip. 57.3 m², ndodhur në katin e dytë, *** Çorovodë, kundrejt çmimit 8,497 lekë, ndërsa në datën 8.9.1998 subjekti i rivlerësimit ia ka shitur⁴⁹ këtë apartament shtetasit L.L kundrejt çmimit 410,000 lekë. Për efekt të analizës financiare paraprake këto të ardhura u pasqyruan në analizën e kryer nga Komisioni për periudhën 1994 – 2003.

31.9 Ndërsa në lidhje me burimin tjetër – kursime të bashkëshortëve – për efekt të analizës financiare janë përlllogaritur të gjitha të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe i bashkëshortes për periudhën 1994 – 2003.

b. Burimet e deklaruara për punimet e ndërtimit për periudhën 2004 – 2012

32. Në lidhje me burimet që kanë shërbyer për kryerjen e punimeve të ndërtimit për periudhën 2004 – 2012, në shumën 4,000,000 lekë, Komisioni i është referuar deklarimeve në deklaratën *Vetting* dhe shpjegimeve të dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ⁵⁰, të analizuar në harmoni me njëra-tjetrën, si vijon: (i) për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit 2+1 të ndodhur në Çorovodë, Skrapar; (ii) për të ardhurat nga kursimet familjare të subjektit.

32.1 Nga hetimi administrativ është konstatuar se në datën 26.10.2007 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i kanë shitur⁵¹ shtetasit F.K pasurinë e llojit “apartament 2+1”, me sip. 70 m², të ndodhur në lagjen “***”, Çorovodë, Skrapar, kundrejt çmimit 1,500,000 lekë. Këtë pasuri subjekti e kishte blerë⁵² më parë, në datën 26.8.1999, kundrejt çmimit 200,000 lekë.

32.2 Komisioni ka hetuar⁵³ në lidhje me çmimin e paguar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 1999, si dhe për të ardhurat e përfituara nga shitja e saj në vitin 2007, ku pas hetimit dhe shpjegimeve⁵⁴ të dhëna nga subjekti i rivlerësimit Komisioni ka përfshirë në analizën financiare paraprake si shpenzim vlerën 200,000 lekë për investimin e blerjes së apartamentit, si dhe si të ardhur në shumën 1,500,000 lekë vlerën e përfituar nga shitblerja e këtij apartamenti në vitin 2007.

32.3 Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortëve të referuar nga subjekti si burim krijimi për punimet, Komisioni ka përlllogaritur në analizën financiare të gjitha të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe i bashkëshortes për periudhat 1994 – 2003 dhe 2004 – 2012.

Analiza financiare

33. Bazuar në deklaratimet e kryera nga subjekti në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit të kryer, Komisioni kreu analizën financiare paraprake me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit dhe personit të lidhur për blerjen e truallit, ndërtimin e godinës, të ndarë në dy periudhat përkatëse 1994 – 2003 dhe 2004 – 2012, të pasqyruar në tabelën si vijon:

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.12.2022.

⁴⁸ Kontratë për privatizimin e banesës datë 2.7.1993, me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 4.10.1993, redaktuar nga noteri publik F.G dhe regjistruar në Hipotekën Skrapar në datën 4.10.1993, me nr. regjistri ***.

⁴⁹ Dokumenti noterial “kontratë shitblerjeje”, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.1998, redaktuar nga noteri publik E.L.

⁵⁰ Në përgjigje të pyetësorëve nr. *** dhe nr. ***.

⁵¹ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., *** kol., datë 26.10.2007, redaktuar nga noteri publik E. L, ndodhur në aneksin nr. ***.

⁵² Kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.8.1999.

⁵³ Referuar VKM-së Nr. 214, datë 28.4.1999, për tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Skraparit, një apartament me sip. 70 m² do të blihej në shumën 750,000 lekë dhe jo 200,000 lekë sa blerë nga subjekti.

⁵⁴ Shihni përgjigjet e pyetjes *** të pyetësorit ***.

Tabela nr. 1

	1994-2003	2005	2006	2008	2009	2010	2011	2012
A) PASURI	3,938,497	532,445	565,885	98,371	1,312,329	523,444	1,638,844	475,034
Apartament banimi 2+1 , L. ***, në Ç. Blerë nga S.R. në datë 25.8.1999 kundrejt çmimit 200,000 lekë	200,000							
Apartament banimi 1+1 , L.***, në Ç. Përfitur me privatizim	8,497							
Ndërtesë një-katëshe me mur guri, L. ***, në Ç. Përfitur me anë të blerjes datë 12.5.1997, çmimi 150,000 lekë dhe më pas	820,000							
Truall me sip. 400 m2, e ndodhur në Mbrostar, Ç, Fier.	380,000							
Shtëpi me sipërfaqe banimi, kati përdhës sip. 99.6 m2 dhe kati i parë 120.6 m2 dhe me truall prej 200 m2, e ndodhur në	2,000,000	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa FR*** e vitit 1987, blerë nga S.R. në datë 19.5.2000, çmimi 530,000 lekë	530,000							
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa AA*** e vitit 2001, blerë nga S.R. në datë 1.6.2009 çmimi 1,000,000 lekë	0				1,000,000			
Ndryshim likuiditeti	0	88,001	121,441	-346,073	-132,115	79,000	1,194,400	30,590
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0
Kredi pranë Intesa Sanpaolo Bank								
C) PASURI NETO (A-B)	3,938,497	532,445	565,885	98,371	1,312,329	523,444	1,638,844	475,034
D) TË ARDHURA	5,117,648	1,068,174	1,104,183	1,189,591	1,674,777	1,630,904	2,815,819	1,667,865
Të ardhurat nga paga S.R.	3,756,814	873,795	855,598	814,798	1,027,080	1,171,949	1,101,859	1,141,722
Të ardhurat nga paga b/shortja e S.R.	950,834	194,379	248,585	374,793	397,697	458,955	493,960	526,143
Të ardhura nga shitja e apartamentit të banimi 1+1 , L. 5 Shtatori, në Ç. Shitur nga S.R. datë 8.9.1998, çmimi 410,000	410,000							
Të ardhura nga shitja e automjetit të llojit *** nr. shasje ***, targa FR***, e vitit 1993, shitur nga S.R. në datë 21.5.2009.					250,000			
Të ardhura nga shitja e ndërimit 51m2 njëkatësh me mur guri, L	0						1,220,000	
E) SHPENZIME	3,360,507	682,785	790,785	1,289,635	1,115,325	1,577,473	1,633,299	1,292,788
Shpenzime jetike	3,260,507	547,785	547,785	580,635	512,325	364,320	330,165	387,816
Shpenzime shkollimi T. A	0	81,000	81,000					
Shpenzime shkollimi E.A	0	27,000	81,000	81,000	54,000			
Shpenzime shkollimi F. A	0	27,000	81,000	81,000	54,000			
Shpenzime qiraje / jetese në Tiranë T, E dhe F.A	0			297,000	495,000	891,000	891,000	891,000
Shpenzime mobilimi shtëpia në Mbrostar - F në Fier.	100,000			250,000		200,000		
Shpenzime udhëtimi / qëndrimi jashtë vendit						122,153	412,134	13,972
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,181,356	-147,056	-252,487	-198,415	-752,877	-470,013	-456,324	-99,957

33.1 Referuar analizës së mësipërme, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura me burime financiare të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për të justifikuar plotësisht blerjen e truallit, ndërtimin e godinës në lagjen “***”, Fier, krijimin e likuiditeteve, kryerjen e investimeve të tjera për blerje pasurish të luajtshme, si dhe për shpenzimet e tjera të deklaruar/evidentuara nga Komisioni, duke rezultuar në pamundësi financiare për periudhën 1994 – 2003 në shumën -2,181,356 lekë dhe për vitet 2005, 2006, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 në shumën -2,377,132 lekë. Mbi bazën e këtij rezultati financiar, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

34. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, për sa i takon analizës financiare, është ndalur tek shpenzimet e tij dhe të familjarëve, duke pretenduar se shpenzimet familjare kanë qenë më të ulëta, duke konsideruar kostot në qytetin e Fierit, si dhe shpenzimet e jetesës për fëmijët duhet të ishin më të ulëta, pasi janë marrë sikur të ishin të rritur.

34.1 Në lidhje me investimin e kryer për banesën në Fier, ka pretenduar që brenda vlerës 2,000,000 lekë, që përfaqëson vlerën e investuar deri në vitin 2003, të përfshihet edhe shuma 190,000 lekë si pjesë takuese e paguar prej tij, e cila do të ulte balancën negative në vlerën rreth 1,800,000 lekë.

34.2 Subjekti, gjithashtu, ka ngritur pretendime edhe për vlerën e kostove të ndërtimit të banesës, duke pretenduar se ALUIZNI e ka vlerësuar pasurinë në shumën 6,000,000 lekë, bazuar vetëm në anën e jashtme të banesës, duke mos bërë një vlerësim të detajuar të pronës si kosto. Ai ka pretenduar se ndërtimi ka pasur kosto më të lirë, pasi edhe çmimet në atë periudhë kanë qenë më të lira për blerjen e materialeve të ndërtimit, duke konsideruar edhe faktin se një pjesë e punimeve është kryer nga subjekti dhe familjarët e tij. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se çmimet e llogaritura nga Komisioni deri në vitin 2013, si dhe shpërndarja e vlerës 4,000,000

lekë, nuk është e saktë, duke shtuar se vlera totale e investimit ka qenë rreth 5,000,000 lekë dhe e shpërndarë deri në vitin 2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

35. Trupi gjykues, duke pasur parasysh provat e administruara gjatë hetimit, deklaramet dhe shpjegimet e subjektit të paraqitura nëpërmjet deklarameteve të pasurive dhe gjatë hetimit administrativ, provat e paraqitura, si dhe pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe e dëgjoji atë në seancë, çmon se:

35.1 Në lidhje me shpenzimet e pretenduara si të përlllogaritura më shumë në analizë, ky pretendim është i pabazuar, pasi Komisioni e ka bazuar analizën financiare në dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit, si dhe mbi bazën e deklarameteve të subjektit. Për sa i përket shpenzimeve të jetesës për subjektet e rivlerësimit, tashmë është konsoliduar praktika⁵⁵ në drejtim të përlllogaritjes së tyre. Këto shpenzime përlllogariten mbi bazën e një standardi minimalist, sipas INSTAT-it, pra mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagave mujore. Ndërsa, për sa i përket shpenzimeve të arsimit dhe qirave të fëmijëve, si dhe çdo shpenzim tjetër, ato janë përlllogaritur bazuar në deklaramet e subjektit gjatë hetimit nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorëve. Subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument provues në pretendimet përfundimtare që të provonte se shpenzimet janë në një masë më të vogël. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për reduktimin e shpenzimeve mbeten të pabazuara.

35.2 Për sa i përket pretendimit për të përfshirë brenda vlerës 2,000,000 lekë, shumën 190,000 lekë, si pjesë takuese e paguar prej tij për blerjen e truallit dhe jo shumën e plotë prej 380,000 lekësh, sikurse është vendosur në analizë, trupi gjykues thekson se në lidhje me këtë çështje nuk rezultoi e provuar gjatë hetimit se trualli ishte blerë bashkërisht nga subjekti dhe vëllai i tij. Trupi gjykues çmon se subjekti gjatë hetimit administrativ paraqiti variante të ndryshme deklaramesh në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së truallit me qëllim uljen e balancës negative në analizën financiare, por nuk arriti të provonte bashkinvestimin, sikurse pretenduar me vëllain e tij, as me kalimin e barrës së provës. Për rrjedhojë, në analizën financiare, zëri i vlerës së investimit për truallin me sip. 400 m², në lagjen “****”, Fier, nuk ndryshoi.

35.3 Në lidhje me pretendimin se vlera totale e investimit nuk është ajo e vendosur nga Komisioni në analizë por më e vogël, duke pretenduar shtrirje më të gjerë ndër vite, pra deri në vitin 2016 dhe jo deri në vitin 2013, trupi gjykues çmon të theksojë në këtë kontekst si fillim se referuar analizës financiare të vënë në dispozicion subjektit, rezultoi se investimi është shtrirë deri në vitin 2012, jo në vitin 2013 siç pretendohet nga subjekti, pasi në janar të vitit 2013 është lëshuar leja e legalizimit dhe referuar dokumentacionit të dosjes së legalizimit dhe fotove të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ⁵⁶, Komisioni ka krijuar bindjen se ndërtimi bashkë me investimet e tjera të pretenduara nga subjekti është shtrirë maksimalisht deri në vitin 2012.

35.4 Në përcaktimin e vlerës totale të investimit, Komisioni është bazuar në deklaramet e subjektit, si dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit⁵⁷, duke qenë se subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor (preventiv, situacion punimesh) me deklaratën *Vetting*, sikurse kërkuar në pikën 26 të udhëzimit nr. 4095/2016, “Për mënyrën e deklaramet të pasurive në zbatim të ligjit nr. 84/2016...” dhe as gjatë hetimit administrativ apo në përfundim

⁵⁵ Shihni vendimin nr. 8/2021 (JR), datë 9.3.2021, të Kolegjit.

⁵⁶ Në pyetësorin *** subjekti paraqiti foto të objektit dorëzuar në Drejtorinë e ALUIZNI-t, si dhe foto të gjendjes aktuale të shtëpisë.

⁵⁷ Vlerat referuese sipas EKB-së në qytetin e Fierit, si dhe vlera e përcaktuar nga ALUIZNI, e deklaruar edhe nga subjekti si vlerë totale në deklaratën *Vetting*.

të tij, me kalimin e barrës së provës ku të bazonte pretendimin e tij në lidhje me vlerën e investimit dhe shpërndarjen e saj ndër vite.

35.5 Në lidhje me pretendimin se vlera e investimit ka qenë më e vogël, duke paraqitur si argument se një pjesë e punimeve janë kryer nga familjarët e tij dhe kostot e ndërtimit për rrjedhojë kanë qenë minimaliste, trupi gjykues i gjeti këto pretendime të pabazuara në fakte, sa kohë subjekti nuk arriti të provojë se kostoja e materialeve të ndërtimit dhe krahu i punës i përdorur për ndërtimin e objektit i kanë kushtuar më lirë se vlera prej 6,000,000 lekësh. Bazuar në sa më lart dhe duke mos disponuar dokumentacion tjetër provues, trupi gjykues arrin në konkluzionin se vlera totale e investimit është 6,000,000 lekë, aq sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

35.6 Trupi gjykues mori në shqyrtim gjithashtu, pretendimin e subjektit në lidhje me shpërndarjen e vlerës prej 4,000,000 lekësh, jo në mënyrë të saktë. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues thekson se kjo vlerë është ndarë në mënyrë të barabartë mesatarisht për vitet 2005 – 2012, në pamundësi të provueshmërisë së shpërndarjes së vlerës nga subjekti i rivlerësimit. Gjithsesi, në një analizë financiare garantiste për këtë periudhë, e cila do të bazohej në deklaratat vjetore⁵⁸ të subjektit 2005, 2006 dhe 2007 në lidhje me vlerën e punimeve shtesë, duke konsideruar se për vitet vijuese 2008 – 2012, ku subjekti nuk ka deklaruar vlerë punimesh, shpërndarja do të bëhej përpjesëtimisht në vlerë të barabartë, balanca negative do të thellohej në shumën -80,555 lekë dhe totali i rezultatit financiar për të gjithë periudhën e investimit do të arrinte nga shuma -2,377,132 lekë në shumën -2,457,687 lekë, pra balanca negative do të ishte më e lartë.

35.7 Si përfundim, nga vlerësimi dhe analizimi i pretendimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, duke konkluduar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për të justifikuar blerjen e truallit dhe ndërtimin e godinës, duke rezultuar me pamundësi financiare në shumën -2,377,132 lekë, balancë e cila e bën deklarin e subjektit të pamjaftueshëm në mungesë të burimeve të ligjshme dhe sjell për pasojë aplikimin e nenit 61/3 të harmonizuar me nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

36. Pasuri e llojit “njësi tregtare”, me sipërfaqe 44.2 m², në Y, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., me certifikatë pronësie nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe 38.70 m². Vlera: 24,310 euro.

36.1 Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar kredinë e marrë së bashku me bashkëshorten D.A, në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 29.8.2014, në shumën 1,000,000 lekë, me këst mujor 32,362 lekë.

37. Deklarimet e kryera në vite që lidhen me këtë pasuri dhe burimet e krijimit të saj

37.1 Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar *blerje dyqani me sipërfaqe 44.2 m², Y, Tiranë. Vlera: 24,310 euro (gjendja e parave të deklaruara në vitet 2008, 2010 dhe 2012, si dhe kredia e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 29.8.2014, kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., notere M. Sh, sipërmarrës A.Gj)*, duke deklaruar edhe kredinë në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 29.8.2014, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”.

⁵⁸ Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 400,000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, *** datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 250,000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar se në pasurinë nr. ***, ***, datë 12.10.1998 (shtëpi banimi), janë kryer punime shtesë në vlerën 300,000 lekë.

37.2 Gjithashtu konstatohet se në deklaratat e interesave privatë të viteve 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredinë bankare të marrë në “Intesa Sanpaolo Bank”.

38. Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:

- Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë, DPPPP-ja dhe “Intesa Sanpaolo Bank”.
- Rezulton se pasuria njësi me sip. 38.7 m², në Y, Tiranë, është transkriptuar pas datës së dorëzimit të deklaratës Vetting.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

39. ASHK⁵⁹ Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2 informon se, nga verifikimi në sistemin elektronik dixhital të regjistrimit të pasurive të paluajtshme rezulton se, në emër të subjektit figuron e transkriptuar pasuria me sipërfaqe 38.7 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

39.1 Në datën 4.8.2014⁶⁰ subjekti i rivlerësimit ka porositur⁶¹ nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit “dyqan”, me sip. 44.2 m², e ndodhur në katin e parë të godinës, shkalla nr. ***, me adresë Y, Tiranë, kundrejt çmimit 24,310 euro.

39.2 Sipas kësaj kontrate është përcaktuar plani i pagesave, si vijon: (i) vlera 14,800 euro është likuiduar në numrin e llogarisë së noteres (bashkëlidhur kontratës vihet re mandati përkatës); (ii) pjesa e mbetur (9,510 euro) do të likuidohej brenda muajit janar 2015.

39.3 Nga administrimi i dokumentacionit⁶² në lidhje me pagesat konstatohet se, subjekti i rivlerësimit: (i) në datën 4.8.2014 ka depozituar *cash* në llogari të noteres M.Sh pranë bankës “Societe Generale Albania”, shumën 14,800 euro, me përshkrimin “pagesë blerjeje dyqani, kësti i parë”; (ii) në datën 1.9.2014 ka depozituar *cash* në llogari të noteres M.Sh, pranë bankës “Societe Generale Albania”, shumën 7,200 euro, me përshkrimin “pagesë blerjeje dyqani, kësti i dytë”; (iii) në datën 10.11.2014 ka depozituar *cash* në llogari të noteres M. Sh, pranë bankës “Societe Generale Albania”, shumën 2,310 euro, me përshkrimin “pagesë blerjeje dyqani, kësti i tretë”.

39.4 Më tej, ka rezultuar se në datën 6.2.2016 është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme⁶³, midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për shitjen e pasurisë së llojit “njësi”, të ndodhur në Y, Tiranë, me sip. 38.7 m², kundrejt çmimit 24,310 euro, për të cilin palët deklarojnë se likuidimi është bërë sipas kontratës noteriale të sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.8.2014.

39.5 Nga informacioni i marrë nga ASHK-ja⁶⁴, konfirmohet se kjo pasuri i është shitur me anë të kontratës së shitjes⁶⁵ së pasurisë të paluajtshme, të datës 30.8.2017, shtetasve R dhe J.Th kundrejt çmimit 31,255 euro.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2020.

⁶⁰ Dokumentacioni i ndodhur në aneksin nr*** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹ Kontratë porositje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.8.2014, redaktuar nga noteri publik M.Sh, e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶² Dokumentacioni i ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së paraqitur nga subjekti si pjesë e dokumentacionit shoqërues të deklaratës Vetting, aneks nr. ***.

⁶³ Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme (njësi) me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2016, redaktuar nga noteri publik M.Sh, e ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.10.2020.

⁶⁵ Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme njësi, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2017, redaktuar nga noteri publik Dh.Q.

40. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) gjendja *cash* e deklaruar më parë si 77% kursime nga shitja e shtëpisë në Çorovodë dhe dyqan në Skrapar; si dhe (ii) kredi në “Intesa Sanpaolo Bank”, 33% kredi në bankë.

40.1 I pyetur nga Komisioni, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar⁶⁶ se burimi i krijimit të fondeve për blerjen e dyqanit në Tiranë, janë: “...kursime të cilat janë deklaruar në deklaratat e pasurisë për vitet 2008, 2010 dhe 2012. Në vitin 2007 kam shitur apartamentin e ndodhur në lagjen ‘***’, Skrapar, në shumën 1,500,000 lekë. Nga shitja e ndërtesës (lokalit) të ndodhur në lagjen ‘***’, Skrapar, me sipërfaqe 51 m², në shumën 1,200,000 lekë... Kësti i dytë, vlera 7,200 euro, është marrë kredi në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në vlerën 1,000,000 lekë. Shuma prej 2,300 euro janë kursimet”.

40.2 Nga analizimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se si burim për pagesën e kështit të parë në shumën 14,800 euro për shlyerjen e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet e tyre, nga shitja e apartamentit dhe të dyqanit të ndodhur në Skrapar dhe të deklaruara në formë *cash* ndër vite. Ndërsa si burim për pagesën e pjesës së mbetur të çmimit, në shumën 9,510 euro, ka shërbyer kredia e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe kursimet e tjera të mundshme deri në datën e kryerjes së pagesës.

Analiza e deklarimeve në vite të likuiditeteve në formë kursimesh gjendje *cash*

41. Duke qenë se referuar fakteve më lart, subjekti ka deklaruar si burim krijimi gjendjen *cash* të akumuluar ndër vite, Komisioni iu referua deklarimeve të tij, ku konstatohet si vijon:

- Në DIPP-në e vitit 2007 deklarohet për herë të parë gjendje *cash* në vlerën 950,000 lekë, me burim nga të ardhurat nga shitja e apartamentit në Çorovodë.

- Në DIPP-në e vitit 2008 nuk deklarohet ndryshime të gjendjes *cash*, por në përgjigje të pyetësorit I të dërguar nga Komisioni, subjekti ka dhënë sqarime lidhur me mënyrën e përdorimit të një pjese të likuiditeteve, gjendje *cash*, ndër të tjera: “...në vitin 2008 janë përdorur rreth 250,000 lekë për vazhdimin e mobilimit të shtëpisë, fonde të cilat kanë qenë nga shitja e apartamentit në vitin 2007, si dhe rreth 250,000 lekë për vazhdimin e ndërtimit të shtëpisë...”.

- Në DIPP-në e vitit 2009 nuk deklarohet shtesa ose pakësim *cash*.

- Në DIPP-në e vitit 2010 subjekti deklarohet: “200,000 lekë gjendje *cash* në shtëpi, krijuar me të ardhurat nga kursimet”.

- Në DIPP-në e vitit 2011 subjekti deklarohet: “Gjendja *cash* në shtëpi, shuma 1,200,000 lekë, e krijuar me të ardhurat nga shitja e objektit të mësipërm” (i referohet dyqanit në Skrapar).

- Në DIPP-të e viteve 2012 dhe 2013 nuk deklarohet shtesa ose pakësim *cash*.

- Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti deklarohet se vlera 24,310 euro, që ka shërbyer për blerjen e dyqanit të ndodhur në Y, ka si burim gjendjen e parave të deklaruara në vitet 2008, 2010 dhe 2012, si dhe kredinë e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank”.

41.1 Nga analizimi i mundësisë financiare të subjektit për të krijuar gjendjen *cash*, Komisioni iu referua analizës financiare⁶⁷, nga ku duket se subjekti dhe personat e lidhur, rezultojnë të jenë në pamundësi financiare për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012 në vlerën totale 1,923,027 lekë. Mbi bazën e këtij rezultati financiar Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

⁶⁶ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

⁶⁷ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare paraprake në fund të këtij vendimi.

42. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka pasur të ardhura nga shitja e pronave, si dhe nga kursimet, që në total kapin vlerën 1,850,000 lekë, por nuk i ka deklaruar çdo vit për shkak të neglizhencës. Nëse do të konsideroheshin këto të ardhura dhe gjendja e kursimeve që janë pasqyruar për vitet 2012 dhe 2013, atëherë balanca do të ndryshonte.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

43. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe pasi e dëgjoi në seancë, i çmon pretendimet e tij të pabazuara. Në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni, për të vlerësuar mundësitë e subjektit për të krijuar gjendjen *cash*, është pasqyruar çdo deklaram i subjektit i kryer në deklaratat periodike vjetore në lidhje me kursimet, si dhe janë analizuar burimet e krijimit nëse ato përfaqësojnë apo jo të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Pretendimet e subjektit se ka pasur gjendje *cash*, nuk mbështeten në legjislacionin në fuqi, pasi bazuar në nenin 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive...”, subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të kursimeve (*cash/likuiditete*) të disponuara deri më 31 dhjetor të vitit përkatës dhe për sa gjendja *cash* e pretenduar nuk është deklaruar në deklaratën periodike përkatëse, pretendimi për përfshirjen në analizë mbetet i pabazuar.

43.1 Bazuar në sa më lart, trupi gjykues konkludon se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për të krijuar gjendje *cash* për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012, duke mbetur e njëjta balancë negative në vlerën totale -1,923,027 lekë.

Analiza e burimeve të krijimit

44. Subjekti ka deklaruar se si burim krijimi kanë shërbyer: të ardhurat nga shitja e apartamentit në Skrapar në vitin 2007, të cilat janë analizuar gjerësisht te pasuria shtëpi banimi, pasi ato kanë shërbyer pjesërisht si burim edhe për punimet e deklaruara në shtëpinë private në lagjen “****”; të ardhurat nga shitja e dyqanit në Skrapar në vitin 2011 si kursime, si dhe kredia e marrë pranë “Intesa Sanpaolo Bank”.

44.1 Referuar DIPP-së së vitit 2003 rezulton se subjekti ka deklaruar, ndër të tjera: “Ndërtesë njëkatëshe me mur guri, vlera 150,000 lekë, e ndodhur në lagjen ‘***’, Çorovodë, Skrapar, me nr. pasurie ***, blerë nga shtetasi M.K, me burim nga kursimet”.

44.2 ZVRPP-ja Skrapar⁶⁸ ka dërguar informacion dhe dokumentacion në lidhje me këtë pasuri dhe nga administrimi i tyre kanë rezultuar këto fakte:

44.2.1 Në datën 12.5.1997 subjekti ka blerë⁶⁹ nga shtetasi M.K një pasuri (ndërtesë/lokal) me sip. 20 m² kundrejt çmimit 150,000 lekë.

44.2.2 Në datën 24.5.1999 subjekti ka kërkuar nga Bashkia Çorovodë pajisjen me një leje sheshit të ndërtimit me sip. 20 m² për ndërtimin e një shtese lokale “artikuj të ndryshëm”, e cila duket se është përbri lokalit që ishte në pronësinë e tij⁷⁰ dhe në datën 25.5.1999, është pajisur nga kjo Bashki me një leje shesh ndërtimi me sip. 22 m², me objekt “shtesë në lokalin ‘farmaci bujqësore’”.

44.2.3 Në vijim, në datën 18.2.2000, subjekti është pajisur nga Bashkia Çorovodë me një leje ndërtimi me objekt “shtesë lokale ekzistues në Çorovodë sipas sheshit të ndërtimit” dhe në datën 9.7.2002 i është lëshuar certifikata e pronësisë për pasurinë e llojit “ndërtesë” me sip. 51 m², e ndodhur në lagjen “*****” në Çorovodë, Skrapar, e cila dukej si bashkim i pasurisë së blerë fillimisht nga shtetasi M.K me objektin e ndërtuar me leje ndërtimi nga vetë subjekti.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2017, pjesë e aneksit nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁹ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.1997, redaktuar nga noteri publik E. L, ndodhur në aneksin *** të dosjes së ILDKPKI-së.

⁷⁰ Ndërtesë e blerë më parë nga subjekti në datën 12.5.1997.

44.2.4 Kjo pasuri figuron e regjistruar me sip. 51 m², lloji “ndërtesë”, e ndodhur në lagjen “****” në Çorovodë, Skrapar, ku në kartelën e kësaj pasurie vihet re shënimi “rivlerësohet në vlerën 1,219,869 lekë” dhe përshkrimi “bashkim pasurie (sip. 22 m² ka ardhur nga ***, f. *** dhe sip. 29 m² ka ardhur nga ***, f. ***)”.

44.2.5 Në datën 21.11.2011, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, përfaqësuar me prokurë nga shtetasi S.P, i kanë shitur⁷¹ shtetasit F.A pasurinë objekt vlerësimi kundrejt çmimit 1,220,000 lekë, për të cilën nuk është paguar tatimi për të ardhurat, pasi subjekti nuk ka pasur fitim në shitblerje për shkak rivlerësimi të mëparshëm në vlerën e shitjes.

44.3 I pyetur nga Komisioni⁷², se përse në deklaratën përkatëse vjetore të pasurisë të vitit 2003 kjo pasuri që ishte shtuar dhe investuar të paktën që nga viti 2000 me 31 m² shtesë sipërfaqeje, nuk ishte deklaruar nga subjekti vlera totale e tij, por vetëm vlera e blerjes fillestare prej 150,000 lekësh, subjekti ka sqaruar se: *“Nga ana ime është deklaruar vlera e blerjes me idenë se ndërtimi ka qenë në vlerë të vogël. Kjo ka qenë arsyeja që kam deklaruar vlerën e blerjes, pa specifikuar shtesën e saj, si dhe vlerën përkatëse. Nga ana ime është bërë kërkesë në Bashkinë Çorovodë dhe pjesa që unë kam ndërtuar ka qenë kufizimi i lokalit, më saktë, sipërfaqja që i përkiste lokalit (edhe sipas lejes së ndërtimit masa e shfrytëzimit të truallit është specifikuar që është përdorur 100%). Në bazë të kësaj kërkesë unë jam pajisur me leje ndërtimi... Punimet kanë filluar në datën 18.2.2000, kohë në të cilën është marrë leja e ndërtimit, punime të cilat kanë zgjatur rreth 2 muaj, e me sa mbaj mend, si dhe referuar preventivit të dorëzuar në bashki, vlera ka arritur në shumën 140,000 lekë lekë...”*. Në mbështetje të deklaratimit të tij, subjekti paraqiti dokumentacionin teknik që nga kërkesa për shesh ndërtimi deri tek leja e ndërtimit, dokumentacionin për rivlerësimin e pasurisë për shitblerjen e saj në vitin 2011, si dhe një preventiv punimesh të lokalit, emërtuar “shitje artikuj të ndryshëm i qytetarit A.Xh”, Çorovodë, datë 20.3.1993, në vlerën 140,000 lekë.

44.4 Nisur nga të dhënat e ndryshme që përfaqësonte preventivi, Komisioni i kërkoi informacion organit kompetent për lëshimin e lejes së ndërtimit, i cili⁷³ në vijim nuk konfirmoi dokumentacion të lëshuar në favor të subjektit të rivlerësimit.

44.5 Duke mos disponuar dokumentacion provues në lidhje me vlerën e ndërtimit, për efekt të analizës financiare, Komisioni iu referua disa vendimeve të Këshillit të Ministrave⁷⁴ për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive të vlerave të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit “K”, për vitin 2000, për qytetin e Skraparit, nga ku duket se kostoja e ndërtimit në vitin 2000⁷⁵ ka qenë në vlerën 21,599 lekë/m² dhe, për rrjedhojë, duket se vlera e ndërtimit të këtij objekti deri në fund të vitit 2000 mund të ketë qenë minimalisht rreth 670,000 lekë⁷⁶. Në analizën financiare paraprake⁷⁷ është reflektuar si shpenzim vlera 150,000 lekë për blerjen e pasurisë fillestare me sip. 20 m², si dhe vlera 670,000 lekë për investimin e kryer nga subjekti për ndërtimin e shtesës 31 m², në këtë objekt (njësi tregtare), pra, në total 820,000 lekë, ndërsa si vlerë të ardhurash të përfituara nga subjekti është përlogaritur vlera e plotë e çmimit të shitjes prej 1,220,000 lekësh sipas kontratës së shitblerjes.

⁷¹ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme – ndërtesë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2011, redaktuar nga noteri publik E. L, ndodhur në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷² Pyetësori nr. ***.

⁷³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2022, të Bashkisë Skrapar (protokolluar në Komision me nr. **** prot., datë 27.12.2022).

⁷⁴ Udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001, udhëzim nr. 3, datë 16.10.2002, si dhe udhëzim nr. 1, datë 8.5.2003, për vitin 2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banësive nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave në tregun e lirë të banësive dhe të koeficientit ‘K’, për qytetin e Skraparit”.

⁷⁵ Në këtë kohë duket se është lëshuar leja e ndërtimit.

⁷⁶ Sipërfaqe totale ndërtimi shtesë 31 m² * 21,599 lekë/m² = 669,569 lekë.

⁷⁷ Vitet 1994 – 2003.

44.6 Në lidhje me burimin tjetër, kredinë e marrë nga “Intesa Sanpaolo Bank”, Komisioni hetoi në lidhje me të, në vijim të të cilit kjo bankë⁷⁸ konfirmon kredinë e marrë nga personi i lidhur në vitin 2014, në shumën 1,000,000 lekë, disbursuar në datën 29.8.2014. Në vijim, nga hetimi kanë rezultuar këto fakte: në datën 1.9.2014 subjekti i rivlerësimit e ka tërhequr *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh me përshkrimin “tërheq *cash* Hysen Ajasllari shpenzime për pagesë këst dyqani”; në datën 1.9.2014⁷⁹ subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogari të noteres M.Sh pranë bankës “Societe Generale Albania” shumën 7,200 euro (ekuivalenti i vlerës 1,000,000 lekë) me përshkrimin “pagesë blerjeje dyqani, kësti i dytë”.

44.7 Bazuar në faktet sa më lart, si dhe në analizën financiare të përgatitur nga Komisioni mbi mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, duket se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në çmimin 24,300 euro (konvertuar në 3,400,000 lekë), pasi nga analiza e burimeve të deklaruara nga subjekti, përkatësisht: (i) gjendja *cash* në shumën 1,850,000 lekë, për krijimin e së cilës subjekti rezultoi në pamundësi financiare; dhe (ii) kredia me vlerë 1,000,000 lekë, e marrë pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, të konsideruara në tërësi, janë të pamjaftueshme për kryerjen e këtij investimi në vlerën 3,400,000 lekë. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

45. Subjekti ka përqendruar argumentet e tij te vlera e investimit të shtesës së ndërtesës, duke pretenduar uljen e saj për shkak se shtesa përfaqëson vetëm një zhvendosje të murit, sipas lejes së ndërtimit, dhe për të bërë të mundur këtë ka përdorur kryesisht të njëjtin material nga muri në fjalë. Pra, ka pretenduar se nuk ka pasur kosto ndërtimi. Ai ka theksuar se ky objekt për shkak të pozicionit të përshtatshëm ku ndodhet ka bërë që të rritet vlera e truallit dhe se për të është kryer rivlerësimi, si dhe janë paguar të gjitha detyrimet e kërkuara nga ligji.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

46. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, çmon se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare të tij dhe personit të lidhur me të për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë dyqan në Y, në vlerën 24,300 euro.

46.1 Në lidhje me vlerën e investimit, trupi gjykues çmon se sikurse ka rezultuar nga hetimi vlera e investimit është bazuar në vlerat referuese të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave në kohën e referuar në lejen e ndërtimit, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, për sa subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues në lidhje me shpenzimet e ndërtimit të shtesës. Trupi gjykues gjithashtu çmon se paraqitja e një preventivi tjetër që nuk i referohet subjektit të rivlerësimit, me qëllim justifikimin e vlerës së investimit, nuk i përshtatet aspak etikës së një magjistrati.

46.2 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e pamundësisë financiare për të krijuar gjendjen *cash* për vitet 2008, 2009, 2010, 2011 dhe 2012, si burimin kryesor për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke rezultuar me balancë negative në shumën -1,923,027 lekë. Si përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë njësi tregtare në Y, Tiranë, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁷⁸ Shkresat nga “Intesa Sanpaolo Bank”: (i) nr. *** prot., datë 16.9.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.9.2020); dhe (ii) nr. *** prot., datë 4.1.2022 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023).

⁷⁹ Dokumentacion i ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

47. Pasuria e llojit “automjet”, tip “**”, me targa AA ***, në vlerën 1,000,000 lekë.** Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2009. Vlera: 1,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

47.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga kursimet familjare ndër vite, si dhe nga shitja e automjetit të mëparshëm.

47.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite:

- Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar blerjen e pasurisë së llojit “automjet”, tip “****”, me targa FR ***, blerë nga shtetasi P.Ç, në shumën 1,000,000 lekë.

- Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar shitjen e pasurisë së llojit “automjet”, tip “****”, me targa FR ***, shtetasit A.K, kundrejt çmimit 780,000 lekë.

47.3 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*
- *Rezulton se automjeti me targa FR ***, i blerë në vlerën 250,000 lekë dhe shitur në vitin 2009 në shumën 780,000 lekë, është përdorur si burim për blerjen e automjetit tip “****”, me targa AA ***, në shumën 1,000,000 lekë.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

47.4 DPSHTRR-ja⁸⁰ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin me targa AA *** (ish FR ***), me nr. shasie ***, tip “****”, vit prodhimi 2001. Nga verifikimi i dokumentacionit – pjesë e dosjes lidhur me këtë automjet – Komisioni konstatoi se:

- i. Në datën 13.5.2009, ky automjet është blerë në Itali, nga shtetasi P.Ç dhe është regjistruar në emër të tij, por nuk evidentohet çmimi i blerjes.
- ii. Në datën 17.5.2009, ky automjet ka hyrë në Republikën e Shqipërisë nga porti i Vlorës.
- iii. Në datën 27.5.2009, janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti në degën doganore Fier⁸¹ dhe duket se janë paguar detyrime doganore në total në shumën 348,430 lekë.
- iv. Në datën 1.6.2009, shtetasi P. Ç ia ka shitur këtë automjet subjektit të rivlerësimit kundrejt çmimit 1,000,000 lekë dhe të nesërmen, në datën 2.6.2009, ky automjet është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

I) Të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm

47.5 DPSHTRR-ja⁸² konfirmon se subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin tip “****”, me targa FR ***, vit prodhimi 1993. Nga verifikimi i dokumentacionit – pjesë e dosjes së dërguar lidhur me këtë automjet – Komisioni konstaton se:

⁸⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2020, e DPSHTRR-së protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2022; dhe shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2017, e DPSHTRR-së, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, aneksi nr. ***.

⁸¹ Mandat bankar i ndodhur në përgjigje të pyetësorit nr. ***, f. ***.

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 28.12.2022, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023.

- i. Shtetasi H.V e ka pasur të regjistruar këtë automjet në pronësi të tij në shtetin gjerman, me targa ***.
- ii. Në datën 4.8.2004 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti në portin e Durrësit, duke paguar në total detyrime doganore në vlerën 178,182 lekë.
- iii. Në datën 18.8.2004, shtetasi H.V ia ka shitur këtë automjet subjektit të rivlerësimit kundrejt çmimit 250,000 lekë.
- iv. Në datën 21.5.2009, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur⁸³ këtë automjet shtetasit A.K, kundrejt çmimit 780,000 lekë.

47.6 Nga hetimi u konstatua se automjeti tip “****”, i blerë në vitin 2004 në shumën 250,000 lekë, është shitur 780,000 lekë në vitin 2009, pra rreth 3 herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes, edhe pse pas 5 vitesh përdorimi/amortizimi prej tij. Subjekti gjatë hetimit⁸⁴ sqaroi se e ka shitur më shtrenjtë automjetin, pasi ka qenë i mirëmbajtur dhe se në atë periudhë ishte rritur edhe dogana.

47.7 Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme në lidhje me vërtetësinë e çmimit të blerjes dhe shitjes së automjetit pas disa vitesh në një vlerë më të lartë, duke arsyetuar se për çmimin e blerjes në shumën 250,000 lekë, referuar dokumentacionit nga hetimi rezultoi se vlera e zhdoganimit të paguar nga pala shitëse ka qenë 178,000 lekë, pa përllogaritur vlerën e blerjes dhe të transportit të automjetit nga shteti gjerman drejt Shqipërisë dhe as fitimin e mundshëm nga pala shitëse për një transaksion shitblerjeje, i cili është kryer 14 ditë pas zhdoganimit të automjetit në Shqipëri. Ndërsa për çmimin e shitjes rreth 3 herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes, duket po ashtu jo i vërtetë, nisur nga përdorimi prej 5 vitesh dhe vlera e tij e amortizimit ndër vite.

47.8 Bazuar në këtë analizë, duke i vlerësuar shpjegimet e subjektit si të pabazuara në ligj dhe prova në lidhje me rritjen e vlerës së shitjes, si dhe nga ana tjetër bazuar në deklarin⁸⁵ e subjektit mbi mospagimin e tatimit të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit, Komisioni ka konsideruar në analizën financiare paraprake si vlerë shitjeje të automjetit në vitin 2009 shumën 250,000 lekë, nën logjikën që subjekti në përcaktimin e çmimit ka pasur qëllim të paktën kompensimin e çmimit të blerjes në vitin 2004⁸⁶. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

48. Në lidhje me vlerën e blerjes prej 250,000 lekësh të automjetit, subjekti ka shpjeguar se është gjetur në mënyrë rastësore në Tiranë tek një shtetas i panjohur më parë, ndërsa për vlerën e shitjes më shtrenjtë ai ka theksuar sërish se e ka shitur më shtrenjtë, duke qenë se automjeti është mirëmbajtur dhe se arsyeja tjetër ka qenë edhe rritja e madhe e doganës.

II) Të ardhurat e deklaruara si kursime familjare

49. Një nga burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* janë edhe kursimet familjare. Nga verifikimi i deklarimeve Komisioni ka konstatuar se subjekti deri në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash*, në shumën 450,000 lekë.

49.1 Për efekt të analizës financiare Komisioni ka përllogaritur të gjitha të ardhurat e krijuara nga paga e subjektit dhe personit të lidhur nga data 1.1.2009 deri në datën e blerjes së automjetit, 1.6.2009. Nga analiza financiare e përgatitur nga Komisioni për periudhën 1.1.2009

⁸³ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.2.2014, redaktuar nga noteri publik Sh.Gj.

⁸⁴ Shihni pyetësin nr. ***.

⁸⁵ Shihni pyetësin nr. ***.

⁸⁶ Duke qenë se në këtë vit subjekti e ka blerë automjetin në vlerën 250,000 lekë.

– 1.6.2009, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 1,000,000 lekë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, automjetit tip “****”, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht: (i) blerjen e automjetit tip “****”, në datën 1.6.2009, si dhe (ii) kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara/evidentuara nga Komisioni, duke rezultuar me balancë negative fondesh në vlerën - 559,495 lekë.

Tabela nr. 2

	Datë 1.6.2009
A) PASURI	870,107
Shtëpi me sipërfaqe banimi, kati përdhes sip. 99.6 m ² dhe kati i parë sip. 120.6 m ² dhe me truall prej 200 m ² , e ndodhur në M, ***, Fier.	222,222
Automjet tip “****” me nr. shasie ***, targa AA ***, e vitit 2001, blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.6.2009, çmimi 1,000,000 lekë	1,000,000
Ndryshim likuiditeti	-352,115
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	870,107
D) TË ARDHURA	790,193
Të ardhurat nga paga, subjekti	412,225
Të ardhurat nga paga, bashkëshortja e subjektit	127,968
Të ardhura nga shitja e automjetit tip “****”, nr. shasie ***, targa FR ***, viti 1993, shitur nga subjekti i rivlerësimit në datën 21.5.2009, çmimi 780,000 lekë	250,000
E) SHPENZIME	479,581
Shpenzime jetike	224,581
Shpenzime shkollimi E.A	45,000
Shpenzime shkollimi F.A	45,000
Shpenzime qiraje/jetese në Tiranë, personi i lidhur	165,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-559,495

49.2 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar në lidhje me pamundësinë financiare për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit në datën 1.6.2009, në shumën - 559,495 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

50. Subjekti, në analizën financiare, ka kundërshtuar vlerën e të ardhurave të vendosura në të nga shitja e automjetit, duke pretenduar se në lidhje me këtë shitje ka përfituar vlerën e plotë prej 780,000 lekësh. Sipas subjektit, nëse në këtë analizë konsiderohet vlera e plotë dhe jo vlera prej 250,000 lekësh sa është konsideruar nga Komisioni, ai nuk do të rezultonte në pamundësi financiare.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

51. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit, çmon se subjekti nuk arriti të provonte se mbi të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga shitja e automjetit, kishte paguar detyrimet tatimore sipas nenit 4, germa “i” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti gjithashtu nuk arriti të provonte pamundësinë financiare për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit në datën 1.6.2009, në vlerën 1,000,000 lekë.

51.1 Si përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë automjet tip “****”, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me balancë negative në shumën - 559,495 lekë.

PERSONAT E LIDHUR

52. Pasuria e deklaruar nga personi i lidhur F.A, e llojit “automjet”, tip “**/****/****/**** (****)”, me nr. shasie ****, vit prodhimi 2001, me targa AA ****, me vlerë 4,300 euro. Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.7.2015, noter G.B.**

52.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar shumën 3,300 euro kursime të vetat nga reklamimet *online* në internet, si dhe diferencën prej 1,000 euro, marrë nga vëllai E.A.

52.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar: “*Blerje automjeti lloji ‘autoveturë’, marka ‘****/****/****/**** (****)’, me nr. shasie ****, vit prodhimi 2001, targa AA ****, me naftë, ngjyrë gri. Blerë nga shtetasi Z.M, Patos, Fier, vlera 4,300 euro, sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., noter G.B, me burim krijimi nga këto 3,300 euro kursime të vetat nga reklamimet online në internet, si dhe diferencën prej 1,000 euro, marrë nga i vëllai E. A”.*

52.3 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

53. DPSHTRR-ja⁸⁷ ka konfirmuar se shtetasi F.A ka të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa AA ****. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti (tip “****”, vit prodhimi 2001) Komisioni ka konstatuar se në datën 14.7.2015 F. A e ka blerë këtë automjet nga shtetasi Z.M kundrejt çmimit 4,300 euro dhe, në vijim, ka kryer procedurat e regjistrimit.

Analizë e burimeve të krijimit – të ardhurat e djemve të subjektit nga puna online

54. Në deklaratën *Vetting*, si dhe në DIPP-në e vitit 2015/2016, personat e lidhur kanë deklaruar përkatësisht të ardhura totale *neto* – të përfituara nga puna e kryer *online* në *website P* dhe *G*, si vijon:

- T. A ka deklaruar në deklaratën *Vetting* llogarinë në “Intesa Sanpaolo Bank” nga *G*, me vlerë 943 euro nga reklamimet në internet, ndërsa në DIPP-në e vitit 2015, vlerën 663 euro dhe në DIPP-në e vitit 2016, vlerën 280 euro, pra, në total për të dyja vitet aq sa ka deklaruar në deklaratën *Vetting*.

- E. A ka deklaruar në deklaratën *Vetting* reklamime *online* nga *G*, me vlerë 2,812 euro dhe nga reklamime *online* nga *P*, me vlerë 2,319 USD. Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar vlerën 2,319 USD, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 vlerën 2,812 euro.

- F.A ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kredituar 1,639 euro dhe reklamime *online* në *P*, vlera 1,876 USD, shuma të cilat janë deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2015.

54.1 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklaramit në deklaratën *Vetting*, nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e përfituara nga djemtë e tij, sikurse kërkohet në udhëzimin nr. 4095/2016, “Për mënyrën e deklaramit të pasurive në zbatim të ligjit nr. 84/2016...”.

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023.

54.2 Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura gjatë hetimit administrativ, i cili ka paraqitur⁸⁸ disa *statement* për llogari të djemve E dhe F. A, pranë “Alpha Bank” dhe, disa faqe në dukje të marra nga *web*-i me kreditime të kryera në platformën *online* të pagesave P, në të cilat duket se janë kredituar shumat e deklaruara nga personat e lidhur.

54.3 Në kuptim të procesit të rivlerësimit, të ardhurat jo vetëm duhen dokumentuar, por edhe të provohet se ato janë të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në këtë kuptim, subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues për të provuar se mbi këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore përkatëse në shtetin dërgues apo në Shqipëri, si shteti pritës.

54.4 Bazuar në sa më lart, Komisioni përgatiti analizën financiare për blerjen e automjetit në shumën 4,300 euro nga personi i lidhur me subjektin në datën 14.7.2015, pa përfshirë në këtë analizë të ardhurat e përfituara nga puna në *web* e djemve të subjektit, derisa subjekti të paraqesë dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Tabela nr. 3

	Datë 14.7.2015
A) PASURI	790,705
Automjet tip “****”, nr. shasië ***, targa AA ***, viti 2001, blerë nga F. A. në datën 14.7.2015, çmimi 4,300 euro	591,895
Ndryshim likuiditeti	198,810
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	790,705
D) TË ARDHURA	1,191,278
Të ardhurat nga paga, subjekti	859,947
Të ardhurat nga paga, bashkëshortja e subjektit	331,331
E) SHPENZIME	843,203
Shpenzime jetike	596,021
Shpenzime kredie (“Intesa Sanpaolo Bank”)	226,534
Shpenzime udhëtimi/qëndrimi jashtë vendit	20,648
Balanca e fondeve (D-C-E)	-442,630

54.5 Nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit rezultoi me balancë negative në shumën - 442,630 lekë për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e automjetit, duke i kaluar për rrjedhojë subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

55. Subjekti i rivlerësimit në qëndrimin e tij ndaloi të ligjshmëria e të ardhurave të përfituara nga shërbimet *web*, duke pretenduar se të ardhurat nga G janë të ligjshme, pasi janë paguar të gjitha detyrimet në vendin e origjinës konform ligjit. Nëse në analizë do të konsiderohen këto të ardhura, nuk do të rezultonte balanca negative.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

56. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit dhe e dëgjoi atë në seancë, çmon se subjekti nuk arriti të provonte deklarinimin e tij në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shërbimet e kryera nëpërmjet platformave të *web*-it.

⁸⁸ Referohuni pyetjes nr. *** të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni dhe përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pyetje.

56.1 Si përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë automjet të blerë nga djali F.A, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke rezultuar me balancë negative në shumën -442,630 lekë.

57. Pasuria e deklaruar nga personi i lidhur T.A, e llojit “automjet”, tip “**”, me nr. shasie ****, me naftë, ngjyrë gri, me targa AA ****, me çmim blerjeje 160,000 lekë sipas kontratës nr. *** rep. dhe nr. *** kol. I njëjti deklaram është kryer nga personi i lidhur edhe në DIPP-në e vitit 2016.**

57.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursime të familjes.

57.2 Konkluzion i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

58. DPSHTRR-ja⁸⁹ ka konfirmuar se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasi T.A, ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa AA ****. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti është konstatuar se në datën 11.11.2016, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., shtetasi T.A e ka blerë këtë automjet nga shtetasi A.K, kundrejt çmimit 160,000 lekë dhe më pas ka vijuar me procedurat e regjistrimit.

Analiza financiare

59. Komisioni përgatiti analizën financiare bazuar në deklaramin e personit të lidhur në lidhje me burimet e krijimit. Në këtë analizë janë përfshirë të gjitha të ardhurat e krijuara nga paga e subjektit dhe personave të lidhur nga data 1.1.2016 deri në datën e blerjes së automjetit, 11.11.2016, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit tip “****” nga shtetasi T.A, në datën 11.11.2016.

Tabela nr. 4

	Datë 11.11.2016
A) PASURI	320,420
Automjet tip “****”, me nr. shasie ****, targa AA ****, viti 2002, blerë nga T. A., në datën 11.11.2016, çmimi 160,000 lekë	160,000
Ndryshim likuiditeti	160,420
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	320,420
D) TË ARDHURA	2,110,675
Të ardhurat nga paga, subjekti	1,316,397
Të ardhurat nga paga, bashkëshortja e subjektit	520,663
Të ardhurat nga punësimi F. A., djali i subjektit	273,615
E) SHPENZIME	1,455,420
Shpenzime jetike	1,014,438
Shpenzime kredie (“Intesa Sanpaolo Bank”)	355,982
Shpenzime mobilimi shtëpia në lagjen “****”, Fier	85,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	334,835

Çështje të tjera

⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023.

60. Pasuria e llojit “automjet” tip “**”, blerë dhe shitur në vitin 2014**

60.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka evidentuar nga deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2014 se, bashkëshortja e tij ka blerë në datën 21.7.2014 një automjet tip “****” vit prodhimi 2002, nga shtetasi P. B, R, D, Fier, në vlerën 204,000 lekë dhe ia ka shitur po në atë vit, në datën 30.10.2014, shtetasit Gj.I, Vlorë, në vlerën 320,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol.

60.2 Nga hetimi i Komisionit DPSHTRR-ja⁹⁰ ka konfirmuar se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka pasur të regjistruar në pronësi të saj automjetin me targa AA *** dhe nga administrimi i dokumentacionit Komisioni ka konstatuar se:

60.2.1 Në datën 21.7.2014, subjekti e ka blerë këtë automjet nga personi fizik tregtar “****” për shumën 204,000 lekë. Nga dokumentacioni është vënë re se, shitësi e ka blerë automjetin në Gjermani kundrejt çmimit 1,000 euro (shuma e konvertuar rreth 140,000 lekë) dhe ka paguar detyrimet në total 200,000 lekë, pa llogaritur shpenzimet e transportit nga vendi i origjinës.

60.2.2 Në datën 21.7.2014 janë kryer procedurat e regjistrimit të këtij automjeti në DRSHTRR-në Vlorë dhe, në vijim, në datën 30.10.2014, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit e ka shitur⁹¹ këtë automjet për shumën 320,000 lekë.

60.2.3 Pra, referuar të dhënave të mësipërme rezulton se çmimi i blerjes nga bashkëshortja e subjektit ka qenë 204,000 lekë dhe brenda një periudhe 3-mujore ky automjet i është shitur një shtetasi tjetër për çmimin 320,000 lekë.

60.3 Komisioni e ka pyetur⁹² subjektin në lidhje me arsyet e rritjes së çmimit të shitjes së automjetit brenda një periudhe 3-mujore nga blerja e tij, duke i kërkuar gjithashtu të paraqiste edhe dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit. Subjekti ka sqaruar se në periudhën e shitjes kishte nevojë për lekë për blerjen e dyqanit në Tiranë dhe në këto rrethana është munduar të gjejë blerësin duke ia shitur më shtrenjtë. Ai gjithashtu ka theksuar se nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara.

60.4 Nga vlerësimi paraprak i deklarimit të subjektit në raport me faktet e konstatuara nga hetimi, Komisioni përlllogarit në analizë si vlerë shitjeje në vitin 2014 shumën 204,000 lekë dhe jo shumën 320,000 lekë sa pretenduar prej tij, për sa subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit dhe sipas logjikës që subjekti në përcaktimin e çmimit ka pasur qëllim të paktën kompensimin e çmimit që ka paguar për blerjen e tij.

60.5 Bazuar në sa më lart, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

61. Subjekti i rivlerësimit ka theksuar se automjetin e ka shitur në çmimin e deklaruar, duke arsyetuar se në atë periudhë ka pasur nevojë për para për blerjen e dyqanit në Tiranë. Në këtë kuptim ka kërkuar që në analizë të përfshihet vlera e plotë e të ardhurave nga shitja në shumën 320,000 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

62. Trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provonte se mbi të ardhurat e pretenduara në shumën 320,000 lekë kishte paguar detyrimet tatimore sipas nenit 4, germa “i” e ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023.

⁹¹ Kontrata e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.10.2014, redaktuar nga noteri publik G.B.

⁹² Shihni pyetësin ***.

në analizën financiare, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, analiza financiare nuk ndryshoi në lidhje me zërin e të ardhurave për këtë pasuri.

63. Pasuria e llojit “automjet” tip “**”, blerë në datën 19.5.2000 dhe shitur në datën 17.8.2004**

63.1 Gjatë hetimit Komisioni ka konstatuar se subjekti ka pasur një automjet tip “****”, të blerë në vitin 2000, të cilin e ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vlerën 370,000 lekë, me burim nga kursimet dhe e ka shitur në vitin 2004 në shumën 200,000 lekë.

63.2 DPSHTRR-ja⁹³ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin me targa FR ***, duke dërguar dosjen përkatëse, nga verifikimi i së cilës është konstatuar se:

- Në datën 19.5.2000, subjekti e ka blerë⁹⁴ këtë automjet nga shtetasi A.H kundrejt çmimit 530,000 lekë.

- Në datën 17.8.2004, subjekti i rivlerësimit e ka shitur⁹⁵ këtë automjet me targa FR *** për shumën 200,000 lekë shtetasit S. G.

63.3 Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me mospërputhjen e deklaramit të tij me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes për automjetin objekt vlerësimi. Në shpjegimet përfundimtare subjekti ka shpjeguar se nuk i ka pasur njohuritë e duhura për plotësimin e deklaratës së parë, duke vendosur në këtë deklaratë vlerën sipas vlerësimit të tij.

63.4 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, i çmon ato jobindëse. Pretendimi i subjektit se ka vendosur vlerën e automjetit sipas vlerësimit të tij është i pabazuar në ligj, pasi në nenin 21 të ligjit nr. 9049/2003 janë përcaktuar kërkesat që duhen zbatuar nga subjektet në deklaramin e tyre, kërkesa të cilat gjenden të specifikuar edhe në rubrikën “sqarime mbi plotësimin e formularit” të deklaratës së plotësuar për herë të parë nga subjekti, i cili ka pasur detyrimin e deklaramit në deklaratën e parë të vlerës së çmimit që ka paguar për blerjen e automjetit. Për rrjedhojë, në analizën financiare është pasqyruar si vlerë blerjeje çmimi i përcaktuar në kontratë nga palët në shumën 530,000 lekë.

63.5 Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin pasurinë objekt vlerësimi, duke e bërë për rrjedhojë deklaramin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 33 dhe pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

64. Në lidhje me dhurimin e deklaruar nga djali i subjektit, E.A

64.1 Gjatë hetimit, Komisioni ka konstatuar se në deklaratën *Vetting*, djali i subjektit, E.A, ka deklaruar dhuratë për shkollim nga një mikeshë e tij nga Finlanda, në shumën 3,000 euro, kaluar nëpërmjet Western Union, deklarim të cilin e ka kryer edhe në deklaratën e vitit 2016.

64.2 Unioni Financiar Tiranë⁹⁶ konfirmon se në emër të personit të lidhur është kredituar nëpërmjet 4 transfertave shuma 3,000 euro, e cila është e ndarë në 4 fatura⁹⁷ tërheqjeje, përkatësisht në datat 15, 16, 17 dhe 18 qershor 2016, në vlerë totale 3,000 euro, me palë dërguese shtetasen I.E nga shteti finlandez, dokumente të paraqitura edhe nga subjekti gjatë hetimit⁹⁸, për sa kërkuar nga Komisioni.

⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.1.2023.

⁹⁴ Kontrata e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.5.2000.

⁹⁵ Kontrata e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.8.2004, redaktuar nga noteri publik D. L.

⁹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.7.2019.

⁹⁷ Faturë nr. ****., datë 15.6.2016, shuma 400 euro; faturë nr. ****., datë 16.6.2016, shuma 1,000 euro; faturë nr. ****., datë 17.6.2016, shuma 1,000 euro; dhe faturë nr. ****., datë 18.6.2016, shuma 600 euro, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹⁸ Në lidhje me pyetjen nr. *** të pyetësorit nr. ***.

64.3 Bazuar në pikën 19 të udhëzimit nr. 4095/2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në zbatim të ligjit nr. 84/2016...”: “Nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë), në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit”. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues, sikurse kërkohet në mbështetje të deklarimit të personit të lidhur me të.

64.4 Në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit ta konfirmonte këtë marrëdhënie dhurimi nga shtetasja finlandeze, si dhe të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor (në formën e kërkuar nga ligji) për të ardhurat e saj të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës së dhuruar në favor të djalit të subjektit E. A.

64.5 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se djali E.A ka humbur çdo kontakt me shtetasen finlandeze, si dhe ka theksuar se të ardhurat e dhuruara prej saj kanë burim të ligjshëm.

64.6 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, çmon se subjekti ka pasur detyrimin të paraqesë bashkë me deklaratën *Vetting* dokumentacionin provues që provon deklarimin e djalit të tij në lidhje me dhurimin e kryer, si dhe të provojë se të ardhurat e dhuruara kanë burim të ligjshëm në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, për sa subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave shuma e dhuruar prej 3,000 euro nuk është konsideruar në analizën financiare.

64.7 Si konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin pasurinë objekt vlerësimi, duke e bërë për rrjedhojë deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 33 dhe pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare për vitet 1994 – 2003 dhe 2004 – 2016

65. Nga analiza financiare paraprake e kryer nga Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, deklarimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare përkatësisht: (i) për periudhën 1994 – 2003, balanca negative e fondeve (-2,181,356 lekë); (ii) për vitin 2005, balanca negative e fondeve (-147,056 lekë); (iii) për vitin 2006, balanca negative e fondeve (-252,487 lekë); (iv) për vitin 2008, balanca negative e fondeve (-198,415 lekë); (v) për vitin 2009, balanca negative e fondeve (-752,877 lekë); (vi) për vitin 2010, balanca negative e fondeve (-470,013 lekë); (vii) për vitin 2011, balanca negative e fondeve (-456,324 lekë); (viii) për vitin 2012, balanca negative e fondeve (-99,957 lekë) (ix) për vitin 2014, balanca negative e fondeve (-280,733 lekë); (x) për vitin 2015, balanca negative e fondeve (-480,855 lekë), pra, me një balancë negative në total në shumën -5,320,076 lekë. Mbi bazën e këtij rezultati financiar, subjekti i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

66. Subjekti në shpjegimet e tij kundërshtoi mënyrën se si është hartuar analiza, duke pretenduar se për sa i përket të ardhurave dhe shpenzimeve për vitet 1994 – 2003 nuk janë pasqyruar të detajuara për çdo vit.

66.1 Subjekti pretendoi se ndërtesa në zërin e aseteve, e cila është llogaritur në vlerën 820,000 lekë (ndërtesa në Çorovodë), nuk duhet të përfshihet në këtë vlerë, por sipas preventivit përkatës.

66.2 Gjithashtu, subjekti ka prapësuar edhe analizën e kryer për investimin e kryer për shtëpinë private në Fier, duke pretenduar si vlerë totale të shpenzimeve shumën 5,000,000 lekë dhe shpërndarjen e saj deri në vitin 2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

67. Trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të paraqitura në këtë seksion janë analizuar në këtë vendim në mënyrë të detajuar në secilën pasuri për të cilën i ka kaluar barra e provës dhe nuk përfaqësojnë pretendime të reja, të cilat do të mund ta përmbysnin rezultatin financiar.

67.1 Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi mënyrën e hartimit të analizës për vitet 1994 – 2003, ajo është hartuar mbi bazën e deklarimeve të subjektit, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të Komisionit, për shpjegimet e së cilës subjektit i është vënë në dispozicion edhe metodologjia e përlllogaritjes së pasqyrës pasuri/të ardhura/shpenzime/detyrime. Për më tepër, subjekti nuk paraqiti një pretendim konkret që të mund të kundërshtonte mënyrën e pasqyrit të kësaj analize.

67.2 Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e rezultatit financiar, duke rezultuar me pamundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, duke rezultuar me balancë negative në total në shumën -5,320,076 lekë.

Konkluzion i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

68. Trupi gjykues, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e subjektit dhe analizoi provat e paraqitura në mbështetje të shpjegimeve të tij, çmon se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës në lidhje me krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime të ligjshme të ardhurash në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën -5,320,076 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b”.

68.1 Subjekti ka kryer deklarime jo në përputhje me ligjin, deklarime të rreme, si dhe ka ndërmarrë veprime të cilat rezultuan se nuk i përshtaten aspak figurës së një magjistrati, duke sjellë për pasojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, shkaqe këto të cilat justifikojnë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5, si dhe nenit 33, pika 5, germat “a”, “b” dhe “ç”.

B. KONTROLLI I FIGURËS

69. Zevendesim me “Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ajo ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.”

69.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin nr. *** prot., datë 30.10.2017, mbi kontrollin e figurës.

69.2 Në vijim, në kuadër të hetimit Komisioni i ka kërkuar DSIK-së⁹⁹ përditësimin dhe deklasifikimin e raportit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

69.3 DSIK-ja ka dërguar raportin për kontrollin e figurës, të përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 14.6.2022, të KDZH-së, sipas të cilit konstatohet se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 13.5.2022.

69.4 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: *Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari.*

Hetimi i Komisionit

70. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

70.1 Nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

71. Në përfundim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

71.1 Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

71.2 Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

72. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale¹⁰⁰, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri¹⁰¹ dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë¹⁰² dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

73. Referuar raportit të hartuar mbi bazën e kritereve të vlerësimit sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016¹⁰³, subjekti i rivlerësimit shfaq korrektësi në zbatimin të ligjit, si dhe identifikon normën ligjore të zbatueshme; shfaq aftësi në arsyetim ligjor, si dhe përpiqet të respektojë rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej tij, duke arritur të respektojë standardin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektiv. Nga analizimi i dosjeve nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave, si

¹⁰⁰ Akt nr. *** prot., datë 31.3.2022.

¹⁰¹ 1) Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. ***, viti 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; 2) vendim “Për pushimin e ndjekjes penale”, për procedimin penal nr. ***, viti 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; 3) konkluzione përfundimtare për çështjen penale nr. ***, viti 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁰² 1) Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 13.7.2016, për kallëzimin penal nr. ***, viti 2016; 2) vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”, datë 16.3.2015; 3) vendim “Për pushimin e procedimit nr. ***”, datë 8.5.2014; 4) kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014” datë 6.6.2014; 5) kërkesë “Për gjykimin e çështjes penale nr. ***/2015”, datë 18.2.2016, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 290, paragrafi 3 dhe 273 i Kodit Penal.

¹⁰³ 1) Aftësitë profesionale; 2) aftësitë organizative; 3) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe 4) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

dhe vërehet se gjuha e përdorur prej subjektit në akte është normale, komunikimi është në përputhje me etikën dhe i qartë.

74. Nga verifikimi i burimeve arkivore rezulton se¹⁰⁴ ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar. Gjithashtu, referuar sistemit të vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale për vitet 2014 – 2016, për subjektin e rivlerësimit është evidentuar se nga vlerësimi tërësor për këto vite është vlerësuar në nivel “mirë”.

Rivlerësimi i kryer nga Komisioni

75. Komisioni ka administruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer si burim për kryerjen e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit. Nga analizimi i tyre u evidentuan disa gjetje që lidheshin me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij për secilën prej tyre, duke u përpjekur për të justifikuar bazueshmërinë në ligj të veprimeve/vendimeve të marra, të cilat vlerësuar nën dritën e proporcionalitetit nuk sjellin impakt negativ në vlerësimin profesional të subjektit, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

76. Në lidhje me dosjen e shortuar nr. 1 – vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 13.7.2016, për kallëzimin penal nr. ****, viti 2016.

76.1 Në lidhje me këtë dosje paraqiten këto fakte: mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasit Z. B, B. B dhe E.K është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 29.6.2016, të cilët kanë kallëzuar se janë pronarë të disa tokave bujqësore të përfituara mbi bazën e ligjit nr. 7501, “Për tokën” dhe se toka e tyre është pushtuar nga shtetasit Q. F dhe E.F, duke paraqitur edhe dokumentacion justifikues. Nga shqyrtimi i kallëzimit vërehet se subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 13.7.2016 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2016, duke u bazuar në nenin 290, pika 1, germa “e” e Kodit të Procedurës Penale, dispozitë e cila rregullon rastet e parashikuara me ligj, mbi bazën e të cilave nuk mund të fillojë procedimi penal, duke arsyetuar se sipas ligjit nr. 7715/1993, hyrë në fuqi në datën 29.6.1993, pushtimi i tokës fillimisht gjykohet nga organet e pushtetit lokal.

76.2 Pas analizimit të dosjes, Komisioni i kërkoi subjektit të provojë bazueshmërinë në ligj të vendimit për mosfillim procedimi penal, pasi referuar ligjit “Për tokën” nuk duket të ekzistojë ndërlidhje midis procedurës administrative të ndjekur nga organet e pushtetit lokal me faktin penal të pushtimit të tokës, sipas nenit 200 të Kodit Penal, në rastet e pushtimit të tokës.

76.3 Gjithashtu, për efekt të ushtrimit të së drejtës ligjore të ankimit nga kallëzuesit, duket se vendimi për mosfillimin e procedimit penal i është komunikuar kallëzuesve gati dy muaj me vonesë¹⁰⁵, në kushtet kur paragrafi 2 i nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale kërkon që vendimi të njoftohet menjëherë.

76.4 Subjekti shpjegoi se në lidhje me këtë çështje ka zbatuar ligjin në fuqi, duke theksuar se pushtimi i tokës fillimisht gjykohej nga organet e pushtetit lokal si kundërvajtje dhe nëse vijojej me shkelje të mëtejshme, shkelësi procedohej penalisht, bazuar kjo edhe në praktikën e ndjekur në lidhje me këto raste. Subjekti shpjegoi gjithashtu se për sa i përket komunikimit të vendimit, ai e ka dorëzuar dosjen në datën e vendimit të mosfillimit dhe se ndjekja e mëtejshme e komunikimit të vendimit nuk është kompetencë e tij, shpjegime këto të cilat u gjetën bindëse nga trupi gjykues.

¹⁰⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021, të sektorit protokoll - arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme.

¹⁰⁵ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 8.9.2016, për komunikim vendim mosfillimi, dërguar për njoftim shtetasve Z.B, B.B dhe E.K.

77. Në lidhje me dosjen e shortuar nr. 3 – procedim penal nr. ***, regjistruar në datën 14.11.2013, për veprën penale “vetëgjyqësia” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 277 - 25 të Kodit Penal, përfunduar me vendimin “Për pushimin e procedimit”, datë 8.5.2014.

77.1 Çështja lidhet me një kallëzim të bërë nga shtetasi H.H, i cili ka kallëzuar se disa familjarë të familjes H e kanë penguar për gëzimin e një toke të përfituar sipas AMTP-së nr. ***, në fshatin M, P. Kallëzimi është referuar në Komisarriatin e Policisë Fier dhe në vijim, pasi janë kryer veprimet e para hetimore i kanë kaluar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

77.2 Subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2013, në datën 14.11.2013, për veprën penale “vetëgjyqësia” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 277 dhe 25 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A.H, Sh.H, L.H dhe A.H.

77.3 Me urdhrin e datës 22.11.2013 subjekti ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore me afat të caktuar, ku në zbatim të urdhrit vërehet se janë kryer vetëm disa nga veprimet hetimore.

77.4 Në vijim, subjekti, me vendimin e datës 14.2.2014, ka disponuar për zgjatjen e afatit hetimor me arsyetimin e domosdoshmërisë për kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore. Në zbatim të këtij vendimi konstatohet se është kryer vetëm një veprim, marrja e konfirmimit nga Bashkia Patos, i cili duket se është i njëjtë me konfirmimin e marrë po nga kjo bashki me shkresën e paraqitur nga kallëzuesi në lidhje me administrimin e përgjigjes së Bashkisë Patos mbi ndjekjen e procedurës administrative mbi bazë ankimi.

77.5 Në datën 8.5.2014, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 328, pika 1, germa “f” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e procedimit nr. ***, datë 14.11.2013, në ngarkim të të pandehurve për veprën penale “vetëgjyqësia” me arsyetimin se në bazë të nenit 5 të ligjit nr. ***/2014, “Për dhënien amnistie” vepra penale “vetëgjyqësia”, e kryer para datës 31.12.2013, amnistohet.

77.6 Në lidhje me këtë dosje, nga analizimi i veprimeve të subjektit janë konstatuar disa *indicie*, të cilat duket se lidhen me aftësinë e subjektit për të drejtuar hetimet dhe ndërmarrë veprimet hetimore të duhura brenda afatit, duke çuar për rrjedhojë zgjatje të panevojshme të hetimeve dhe mosjustifikim të vendimit për zgjatje afati. Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

77.7 Subjekti ka shpjeguar se hetimi ka qenë i plotë dhe se ka kryer verifikimet përkatëse, të cilat kanë qenë të domosdoshme pavarësisht dokumentacionit të dorëzuar nga kallëzuesi. Në materie të çështjes, ai është shprehur se çështja me tokat mbetet problem, pasi dhe vetë bashkia nuk i ka dhënë zgjidhje ligjore problemit, por e ka vështirësuar punën e prokurorëve duke bërë që të kryhen të gjitha verifikimet e mundshme lidhur me pretendimet e palëve.

77.8 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e palëve, i çmon ato të pabazuara dhe jobindëse sepse subjekti nuk arriti të provonte në lidhje me kryerjen e veprimeve të duhura hetimore brenda afatit të caktuar, pamundësinë për t’i përfunduar ato në kohë, si dhe domosdoshmërinë për zgjatjen e afatit në një çështje, e cila në këndvështrim të fakteve të referuara dhe volumit të veprimeve hetimore nuk duket aspak komplekse. Gjithsesi, këto mangësi të konstatuara në këtë çështje nuk përbëjnë shkak të mëvetësishëm për të aplikuar nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit, për sa nuk janë evidentuar të jenë kryer në mënyrë të përsëritur nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me disa hetime për informacionet nga burimet arkivore

78. Komisioni, për efekt të rivlerësimit profesional të kryer ndaj subjektit, ka konsideruar edhe informacionin e marrë nga burimet arkivore duke hetuar në mënyrë të pavarur.

78.1 Nga të dhënat burimore të përcjella me raportin e KLP-së është vënë re se subjekti i rivlerësimit ka marrë masë disiplinore “vërejtje” me urdhrin nr. ***, datë 3.4.2007, të

Prokurorit të Përgjithshëm. Si shkaqe të marrjes së kësaj mase janë vërejtur kryesisht zvarritje të pajustificuara në hetim, si dhe shkelje të tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

78.2 Komisioni, në kuadër të hetimit të plotë dhe të pavarur ka administruar¹⁰⁶ dosjen hetimore në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2006, të referuar në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, në të cilin paraqiten këto fakte:

78.3 Mbi bazën e materialit hetimor të përcjellë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier është kryer regjistrimi i procedimit penal nr. ***/2006, nga prokurori i rrethit për veprën penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 289/3 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. B, ku për hetimin e këtij procedimi është caktuar subjekti i rivlerësimit. Në këtë material hetimor referohet se shtetasi M.B u ka premtuar shtetasve L.Ll dhe B.K se nëpërmjet një shtetasi nga Patosi do të mund të kalonin në mënyrë të paligjshme kufirin për në shtetin grek kundrejt shumës 800 euro. Nga të dhënat e mëtejshme referohet se ata janë kapur nga policia kufitare dhe janë kthyer mbrapsht bashkë me disa shtetas të tjerë.

78.4 Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.7.2006, me qëllim grumbullimin e të dhënave të nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit dhe veprës penale, si dhe individualizimin e përgjegjësisë penale ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore kryesisht në lidhje me shtetasin M. B dhe shtetasin nga Patosi që referohet se ka bërë të mundur kalimin e kufirit. Në vijim, pas rreth 7 muajsh, në datën 14.2.2007 ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, tashmë kryesisht ndaj shtetasit L. Ll, si i dëmtuar nga vepra penale.

78.5 Në datën 10.7.2007 ka urdhëruar regjistrimin e shtetasit L.Ll në regjistrat e personave që i atribuohet vepra penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal dhe me kërkesën e datës 11.7.2007 ka kërkuar para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier gjykimin e shtetasit L.Ll, akuzuar për veprën penale “kallëzim i rremë”.

78.6 Në lidhje me këtë çështje Komisioni, pasi analizoi faktet dhe veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, konstatoi se nga regjistrimi i procedimit penal e deri në dërgimin në gjyq të të akuzuarit kishte kaluar 1 vit, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin për 1 vit radhazi. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

78.7 Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur zvarritje të hetimeve, por në lidhje me këtë çështje janë kryer disa veprime për të identifikuar shtetasin M.B, si i dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale, veç të tjerash ka ndikuar edhe periudha e pushimit, muaji gusht, koha e lëvizjes së dosjes Fier - Vlorë - Prokurori e Përgjithshme - Fier. Në përfundim të hetimit të këtij procedimi penal është arritur në konkluzionin se shtetasi L. L (i cili fillimisht ka dhënë emrin e shtetasit Muço Bushi si të dyshuar e, më pas, ka sqaruar se këtë emër e ka referuar për shkak të presionit të bërë nga policia) ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “kallëzim i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal.

78.8 Trupi gjykues, duke pasur parasysh kohën për transferimin e dosjes Vlorë - Fier - Prokurori e Përgjithshme - Fier, për shkak kompetence, veprimet e kryera në dinamikë për identifikimin e autorit e deri në regjistrimin e shtetasit, të cilit i atribuohet vepra penale, çmon se në lidhje me këtë çështje ka pasur zvarritje të hetimit, të cilat mund të ishin evituar, pasi çështja nuk duket të ketë qenë komplekse. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar cilësi për të ndërmarrë hapa të duhur hetimorë brenda një afati të arsyeshëm, kriter matës ky i aftësive organizative për subjektet e rivlerësimit. Por, duke qenë se për të njëjtin shkak subjekti është penalizuar më parë me masën disiplinore “vërejtje” në vitin 2007 dhe me qëllim mosrëndimin e pozitës së tij në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se zvarritja

¹⁰⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2023, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.1.2023.

e hetimit në këtë çështje, parë nën dritën e proporcionalitetit, nuk sjell për pasojë penalizimin e subjektit në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

78.9 Nga administrimi i informacioneve të gjetura nga burimet arkivore për subjektin e rivlerësimit është mbajtur në konsideratë gjithashtu edhe një ankesë e vitit 2017¹⁰⁷, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm me objekt “kërkesë për informacion dhe verifikime të veprimeve të subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. ***/***”¹⁰⁸.

78.10 Komisioni, pasi tërhoqi¹⁰⁹ dosjen e plotë hetimore dhe e analizoi atë, nuk evidentoi *indicie* në kuptim të kriterëve për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

DENONCIME

79. Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 2 denoncime të ardhura në adresë të Komisionit. Nga administrimi dhe vlerësimi i tyre, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, u gjetën disa *indicie* në kuadër të kriterit profesional, për të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

79.1 Denoncim i shtetasit S.H¹¹⁰, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për moskryerje të hetimit të plotë në lidhje me dosjen penale nr. ***/2020, duke pretenduar konkretisht se nuk ka kryer asnjë veprim hetimor ndaj personit të tretë të përfshirë në ngjarje, për shkaqe korruptive.

79.2 Komisioni administroi¹¹¹ dosjen penale, nga ku vërehet se në datën 18.9.2020, mbi bazën e materialit hetimor të ardhur nga Komisariati i Policisë Fier, është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ku referohet se shtetasit E. D dhe L.H, fqinjë, në datën 24.7.2020 janë konfliktuar fizikisht me njëri-tjetrin (për një kanal të ujërave të zeza që derdhet në shtëpinë e njërit prej tyre), duke pësuar secili dëmtime trupore. Në këtë konflikt është përfshirë edhe shtetasi B.D, djali i shtetasit E.D.

79.3 Për hetimin e rrethanave të kësaj çështjeje, subjekti ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore në lidhje me shtetasit E.D dhe L. H, duke lënë pa përfshirë shtetasin B.D, i cili, referuar dëshmitëve, citohet se ka ndërmarrë veprime aktive duke qëlluar shtetasin L.H me drurin e një lopate në brinjë dhe në kokë. Nga akt ekspertizat e lëshuara për shtetasit E.D dhe L. H është konkluduar se të dëmtuarit kanë humbur aftësinë për punë mbi 9 ditë.

79.4 Pasi janë kryer veprimet hetimore, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e shtetasve E. D dhe L.H në regjistrin e personave që i atribuohet vepra penale, akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe, në vijim, ka proceduar me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Me vendimin nr. ***, datë 22.11.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarinimin fajtor të të dy shtetasve dhe dënimin e tyre me gjobë në shumën 150,000 lekë/secili.

79.5 Nga analizimi i këtij procedimi penal, Komisioni vuri re se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime të plota hetimore, pasi nuk duket të jetë kryer asnjë veprim hetimor ndaj shtetasit B.D, i cili nga faktet e referuara dhe nga dëshmitë e dhëna nga bashkëshortët H, referohet se ka

¹⁰⁷ Praktika nr. *** prot., me ankues B. K.

¹⁰⁸ Në lidhje me një ngjarje të rëndë, aksident me pasojë vdekjen e vëllait të ankuesit të ndodhur në datën 24.12.2016.

¹⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.1.2023.

¹¹⁰ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 28.6.2021.

¹¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

qenë i përfshirë në këtë konflikt¹¹² dhe ka ndërmarrë veprime aktive duke qëlluar shtetasin L.H me drurin e një lopate në brinjë dhe në kokë.

79.6 Në lidhje me këtë shtetas, u evidentua se vetëm pas kalimit të një periudhe prej 6 muajsh nga urdhri për kryerjen e veprimeve hetimore, lëshuar nga subjekti i rivlerësimit, është proceduar me kërkimin e tij, por nuk është gjetur dhe, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS¹¹³, referohet se *shtetasi B.D ka dalë për herë të fundit në datën 27.3.2021 nga porti i Durrësit dhe, pas kësaj date, nuk ka hyrje në territorin shqiptar*. Për rrjedhojë, referuar këtyre fakteve, duket se këtij shtetasi i është krijuar mundësia për t'iu shmangur veprës penale. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

79.7 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikundër gjatë hetimit të fakteve, duke u përpjekur të justifikojë veprimet e urdhëruara. Ai ka shpjeguar se hetimi për këtë procedim penal është kryer i plotë. Lidhur me shtetasin B.D ka shpjeguar se nuk është bërë e mundur gjetja dhe, për pasojë, nuk është realizuar as pyetja e tij. Në lidhje me gjetjen e tij janë bërë përpjekje të vazhdueshme dhe se kryerja e veprimeve hetimore për gjetjen e tij tregon që synimi nuk ka qenë shmangia e përgjegjesisë penale për shtetasin B. D. Në përfundim të hetimit janë marrë të pandehur dy shtetasit E.D dhe L.H për konsumimin e elementeve të figurës së veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, të cilët janë deklaruar fajtorë për veprën penale për të cilën janë akuzuar me vendimin nr. ***, datë 22.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, paraqitur në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit.

79.8 Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se në këtë procedim penal janë kryer veprime të plota hetimore. Kërkimi i shtetasit B.D, i cili referohej në faktet penale, është kryer pas një periudhe kohore relativisht të gjatë nga lëshimi i urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore, fakt i cili duket se ka lehtësuar edhe pozitën e tij për t'iu shmangur përgjegjesisë penale. Një nga funksionet kryesore të prokurorit, sipas nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale, është drejtimi dhe kontrolli i hetimeve paraprake dhe veprimtarisë së policisë gjyqësore, funksion i cili nuk duket të jetë zbatuar nga subjekti i rivlerësimit në rastin konkret, pasi ai ka pasur detyrimin të drejtonte radhën e veprimeve hetimore dhe se kërkimi i këtij shtetasi pas afërsisht 6 muajsh i ka krijuar atij terren për shmangien nga përgjegjësia penale.

79.9 Trupi gjykues, nga ana tjetër, duke pasur parasysh kryerjen e veprimeve hetimore në drejtim të dy shtetasve të konfliktuar me njëri-tjetrin, të cilët janë referuar në këtë procedim penal, marrjen në përgjegjësi penale, si dhe dënimin e tyre nga gjykata kompetente, sikurse kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, çmon se mangësia e konstatuar në këtë procedim nuk e penalizon subjektin në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit.

80. Denoncim i shtetasës S. S¹¹⁴, e cila ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe një subjekt tjetër, prokuror, për vendime të padrejta në lidhje me pushimin e çështjes, ku denoncuesja ka qenë viktimë e një aksidenti automobilistik të kryer nga shtetasja V..

80.1 Në lidhje me këtë denoncim Komisioni, duke vlerësuar faktet e paraqitura, tërhoqi¹¹⁵ dosjen penale¹¹⁶ të vitit 2008, nga ku kanë rezultuar këto fakte. Ka rezultuar se denoncuesja ka qenë duke udhëtuar në një automjet në rrugën *** - Fier dhe në vendin e quajtur “****” është futur në parakalim shtetasja V.M, e cila është përballur me një automjet që po lëvizte me shpejtësi dhe me qëllim evitimin e përplasjes me këtë automjet është shmangur dhe, për pasojë,

¹¹² Për më tepër shihni procesverbalin e datës 30.3.2021 të shtetasës A.H, pjesë e dosjes penale.

¹¹³ Datë 29.3.2021.

¹¹⁴ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 19.9.2019.

¹¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.12.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹¹⁶ Nr. procedimi ***/2008.

ka dalë nga rruga dhe ka goditur automjetin, ku ka qenë në vend të parë shtetasja S.S, e cila nga përplasja ka pësuar dëmtime trupore.

80.2 Mbi bazën e këtyre fakteve është regjistruar procedimi penal në datën 15.10.2008 nga një prokuror¹¹⁷ pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Pasi janë kryer veprimet hetimore, ndër këto edhe ekspertiza¹¹⁸, e cila ka përcaktuar se dëmtimet ndaj shtetasës S.S kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme në punë në masën mbi 9 ditë (pra, dëmtime të lehta).

80.3 Prokurori i çështjes, pasi ka administruar ekspertizën, me vendimin e datës 24.11.2008 e ka pushuar procedimin penal. Në vijim, vendimi është ankimuar nga e dëmtuara duke pretenduar se dëmtimet e pësuar kanë qenë me pasoja më të rënda, krahu i dëmtuar nga aksidenti është jashtë funksionit dhe, për rrjedhojë, duhet kryer riekspertim duke e mbështetur në akte provuese. Në përfundim ka kërkuar se vendimi për pushimin e procedimit penal duhet prishur, pasi nuk ka qenë i bazuar duke urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier të vazhdojë hetimet në lidhje me procedimin penal¹¹⁹.

80.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 7.4.2008, ka vendosur pranimin e ankimit të ankueses, duke urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier të vazhdojë hetimet në lidhje me procedimin penal, duke përcaktuar se organi i hetimit duhet të urdhërojë kryerjen e një riekspertimi, si dhe të hetojë edhe për faktin nëse rëndimi i gjendjes shëndetësore të të dëmtuarës S. S është pasojë e aksidentit të ndodhur në datën 3.4.2008, apo i rrethanave të tjera që janë të shkëputura nga ajo e aksidentit, duke e bazuar këtë vendim në dy dokumente të reja shkresore të datës 6.4.2009, të lëshuara nga dy mjekë, në të cilat janë pasqyruar fakte të reja¹²⁰. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 19.5.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

80.5 Në zbatim të këtij vendimi çështja ka vijuar të ndiqet nga subjekti i rivlerësimit, i caktuar me vendimin për zëvendësimin e prokurorit¹²¹, datë 30.6.2010 nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka urdhëruar riaktekspertimin mjekoligjor me 3 ekspertë. Me aktekspertimin nr. ***, datë 2.8.2010, të lëshuar nga ekspertët, është konkluduar në lidhje me të njëjtat konstatime si në aktin e mëparshëm, duke u konfirmuar se dëmtimet kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme në punë në masën mbi 9 ditë.

80.6 Mbi bazën e këtij konkluzioni mjekësor, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 24.9.2010 për pushimin e procedimit penal, ka pushuar procedimin penal për arsye se nga ana e shtetasës V.M nuk janë konsumuar elementet e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, pasi ndaj të dëmtuarës është shkaktuar një plagosje e lehtë dhe se neni 290 i Kodit Penal kërkon që për të pasur përgjegjësi duhet jo vetëm shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, por edhe ardhja e pasojave kriminale si vdekja e një personi, dëmtimi i rëndë i shëndetit të një personi dhe plagosja e lehtë e disa personave.

80.7 Në lidhje me këtë procedim Komisioni, pasi analizoi veprimet e urdhëruara nga subjekti i rivlerësimit, vuri re se pyetjet e drejtuara ekspertëve ishin të njëjta “standarde” si ato të bëra në aktekspertimin e parë dhe se dokumentacioni mbi bazën e të cilit do të rikryhej aktekspertimi ishte po ai i njëjti, dorëzuar më parë ekspertit për përgatitjen e aktit të parë datë 31.10.2008.

¹¹⁷ Z. P.V.

¹¹⁸ Aktekspertiza nr. ***, datë 31.10.2008.

¹¹⁹ Nr. ***/2008.

¹²⁰ Fakti se e dëmtuara ka atrofi muskulare, ka pengesa funksionale të bërrylit dhe supit të shkallës mesatare dhe se kjo gjendje justifikon edhe një operacion.

¹²¹ Për shkak të vendimmarrjes së tij në lidhje me mënyrën e përfundimit të çështjes.

80.8 Për rrjedhojë, këto fakte i krijuan Komisionit *indicie* për t'i kërkuar subjektit të provonte të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, se nuk duket të jetë zbatuar vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për kryerjen e veprimeve të plota hetimore për të përcaktuar nëse pasojat e pretenduara nga e dëmtuara janë shkaktuar nga aksidenti i datës 3.4.2008 apo ndonjë shkak tjetër i mëvonshëm.

80.9 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar radhën e veprimeve të kryera pas ardhjes së dosjes nga gjykata kompetente. Ai ka shpjeguar se me vendimin e datës 5.7.2010 është kërkuar kryerja e ekspertimit mjekoligjor për shtetasen S.S, duke caktuar si ekspertë specialistë të Mjekësisë Ligjore Tiranë dhe për kryerjen e këtij akti, subjekti ka dërguar dokumentacionin e dosjes në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë¹²². Për kryerjen e këtij ekspertimi Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë ka kërkuar që e dëmtuara të paraqitet pranë këtij institucioni për ekzaminim fizik. Subjekti ka theksuar se grupi i ekspertëve në përfundim ka lëshuar aktin e ri me nr. ***, datë 2.8.2010, të cilin e kanë bazuar jo vetëm në dokumentacionin e çështjes, por edhe në ekzaminimin fizik të të dëmtuarës, duke paraqitur në cilësinë e provave shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2010, të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë në lidhje me kërkesën e ekspertëve për paraqitjen fizikisht të të dëmtuarës, si dhe aktekspertimin mjekoligjor nr. ***, datë 2.8.2010, të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, ku vërehet e shënuar se akti u përgatit mbi bazën e dokumentacionit dhe ekzaminimit fizik të shtetases S. S.

81. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti, i çmon ato bindëse dhe të bazuara në dokumentacionin e paraqitur në cilësinë e provave. Subjekti i rivlerësimit provoi para Komisionit se veprimet e urdhëruara nga ana e tij janë fokusuar në fushën teknike, duke caktuar ekspertë të fushës, të cilët kanë përgatitur raportin e ri të bazuar në dokumentacionin e disponuar në dosje, si dhe mbi bazën e ekzaminimit fizik të të dëmtuarës dhe se vendimi i pushimit të procedimit është bazuar në përfundimet e riekspertizës. Trupi gjykues, duke pasur parasysh karakterin teknik të veprimeve të nevojshme në të tilla raste, shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

82. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e tij, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

82.1 Trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Hysen Ajasllari ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konkludon se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, si dhe në vlerësimin e përgjithshëm të çështjes, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin te publiku, në kuptim të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

¹²² Duke referuar shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2010, mbi bazën e së cilës ka përcjellë dokumentacionin.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysen Ajasllari, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 3.3.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE PARAPRAKE

	1994-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	3,938,497	694,444	532,445	565,885	1,350,031	98,371	1,312,329	523,444	1,638,844	475,034	-90,337	1,767,013	717,573	169,380
Apartament banimi 2+1 , L. ***, në Ç. Blerë nga S.R. në datë 25.8.1999 kundrejt çmimit 200,000 lekë	200,000													
Apartament banimi 1+1 , L.***, në Ç. Përfitur me privatizim	8,497													
Ndërtesë një-katëshe me mur guri, L. ***, në Ç. Përfitur me anë të blerjes datë 12.5.1997, çmimi 150,000 lekë dhe më pas ndërtimi i shtesës në vitin 2000	820,000													
Truall me sip. 400 m2, e ndodhur në Mbrostar, Ç, Fier.	380,000													
Shtëpi me sipërfaqe banimi, kati përdhes sip. 99.6 m2 dhe kati i parë 120.6 m2 dhe me truall prej 200 m2, e ndodhur në Mbrostar, Ç, Fier	2,000,000	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444	444,444				
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa FR*** e vitit 1987, blerë nga S.R. në datë 19.5.2000, çmimi 530,000 lekë	530,000													
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa FR*** e vitit 1993, blerë nga S.R. në datën 18.8.2004, çmimi 250,000 lekë	0	250,000												
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa AA*** e vitit 2001, blerë nga S.R. në datë 1.6.2009 çmimi 1,000,000 lekë	0						1,000,000							
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa AA***, e vitit 2002, blerë nga b/sh e S.R. në datë 21.7.2014 çmimi 204,000 lekë	0											204,000		
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa AA*** e vitit 2001, blerë nga F.A. në datë 14.7.2015 çmimi 4,300 euro	0												591,895	
Automjet i llojit *** nr. shasje ***, targa AA*** e vitit 2002, blerë nga T.A. në datë 11.11.2016, çmimi 160,000 lekë	0													160,000
Njësi tregtare me sip. 44 m2, e ndodhur në Yzberisht, Tiranë	0											3,404,673		
Ndryshim likuiditeti	0	0	88,001	121,441	905,587	-346,073	-132,115	79,000	1,194,400	30,590	-90,337	-1,841,660	125,678	9,380
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,000,000	0	0
Kredi pranë Intesa Sanpaolo Bank												1,000,000		
C) PASURI NETO (A-B)	3,938,497	694,444	532,445	565,885	1,350,031	98,371	1,312,329	523,444	1,638,844	475,034	-90,337	767,013	717,573	169,380
D) TË ARDHURA	5,117,648	1,262,749	1,068,174	1,104,183	2,691,002	1,189,591	1,674,777	1,630,904	2,815,819	1,667,865	1,715,674	2,169,380	2,027,090	2,400,750
Të ardhurat nga paga S.R.	3,756,814	885,220	873,795	855,598	896,619	814,798	1,027,080	1,171,949	1,101,859	1,141,722	1,187,178	1,400,286	1,459,094	1,431,050
Të ardhurat nga paga b/shortja e S.R.	950,834	177,529	194,379	248,585	294,383	374,793	397,697	458,955	493,960	526,143	528,496	565,094	567,996	567,996
Të ardhurat nga punësimi T.A. djali i S.R.	0													53,951
Të ardhurat nga punësimi E.A. djali i S.R.	0													
Të ardhurat nga punësimi F.A. djali i S.R.	0													347,753
Të ardhura nga shitja e apartamentit të banimit 1+1 , L. 5 Shtatori, në Ç. Shitur nga S.R. datë 8.9.1998, çmimi 410,000 lekë	410,000													
Të ardhura nga shitja e automjetit të llojit *** nr. shasje ***, targa FR*** e vitit 1987, shitur nga S.R. datë 17.8.2004		200,000												
Të ardhura nga shitja e apartamentit të banimit 2+1 , L. ***, në Ç. Përfitur me privatizim	0				1,500,000									
Të ardhura nga shitja e automjetit të llojit *** nr. shasje ***, targa FR***, e vitit 1993, shitur nga S.R. në datë 21.5.2009. çmimi 780,000 lekë							250,000							
Të ardhura nga shitja e ndërtimit 51m2 njëkatësh me mur guri, L. ***, në Ç	0								1,220,000					
Të ardhura nga shitja e utomjetit i llojit *** nr. shasje ***, targa AA*** e vitit 2002, shitur nga b/sh e S.R. në datë 30.10.2014 çmimi 320,000 lekë												204,000		
E) SHPENZIME	3,360,507	469,320	682,785	790,785	901,635	1,289,635	1,115,325	1,577,473	1,633,299	1,292,788	1,355,471	1,683,100	1,790,372	1,648,804
Shpenzime jetike	3,260,507	469,320	547,785	547,785	580,635	580,635	512,325	364,320	330,165	387,816	387,816	879,992	1,121,380	1,175,460
Shpenzime shkollimi T. A	0		81,000	81,000	60,000									
Shpenzime shkollimi E.A	0		27,000	81,000	81,000	81,000	54,000							
Shpenzime shkollimi F. A	0		27,000	81,000	81,000	81,000	54,000							
Shpenzime qiraje / jetese në Tiranë T, E dhe F.A	0				99,000	297,000	495,000	891,000	891,000	891,000	891,000	396,000		
Shpenzime per licence avokatie Hysen Ajasllari	0											112,000		
Shpenzime kredie (ISP Bank)													97,086	388,344
Shpenzime për ALUIZNI-n	0										71,046			
Shpenzime mobilimi shtëpia në Mbrostar - F në Fier.	100,000						250,000					170,000	260,000	85,000
Shpenzime udhëtimi / qëndrimi jashtë vendit								122,153	412,134	13,972	5,608	28,022	20,648	0
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,181,356	98,985	-147,056	-252,487	439,336	-198,415	-752,877	-470,013	-456,324	-99,957	450,540	-280,733	-480,855	582,566

